

**UNIVERSITETI I EVROPËS
JUGLINDORE**

**SOUTH EAST EUROPEAN
UNIVERSITY**

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I DREJTËSISË

FACULTY OF LAW

ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE

PUNIM MAGJISTRATURE

TEMA:

**“POZITA E FËMIJËVE NË KONFLIKT ME LIGJIN NË PROCEDURË
PENALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT”**

Kandidat:

Nedim Izairi

Mentor:

Doc. Dr. Blerta Ahmedi Arifi

Tetovë, 2019

Falemnderim

ABSTRAKT

**"Pozita e fëmijëve në konflikt me ligjin në procedurë penale në Republikën e
Maqedonisë së Veriut"**

АПСТРАКТ

**“ Положбата на децата во судир со законот во кривична постапка во
Република Северна Македонија”**

DEKLARATË

Vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij punimi.

Nedim Izairi

PËRMBAJTJA

HYRJE.....7

1. Lënda e hulumtimit	7
2. Qëllimet e hulumtimit	7
3. Hipotezat	7
4. Metodologjia e hulumtimit.....	8
5. Rëndësia e punimit.....	11
6. Strukturimi i punimit.....	11

Kapitulli I

1. KARAKTERISTIKAT, BURIMET DHE PARIMET NË PROCEDURËN NDAJ FËMIJËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

1.1. Përkufizimi i nocionit fëmijë dhe kategorizimi i fëmijëve sipas • LIGJI PËR DREJTËSINË E FËMIJËVE I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË. (2013). “GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.” NR. 148 /2013.....	12
1.2. Mosha minimale për përgjegjësi penale bazuar në legjislacionin pozitiv të RMV.....	13
1.3. Karakteristikat e të drejtës penale ndaj fëmijëve.....	14
1.4. Burimet e të drejtës penale ndaj fëmijëve.....	16
1.5. Parimet e veprimit me fëmijë.....	17

1.6.	Parimet themelore të procedurës gjyqësore ndaj fëmijëve	18
------	---	----

Kapitulli II

2. SUBJEKTET NË PROCEDURËN PENALE NDAJ FËMIJËS

2.1.	Këndvështrim i përgjithshëm ndaj subjektet procedurale	22
2.2.	Gjykata kompetente në procedurë ndaj fëmijëve.....	23
2.3.	Prokurori publik për veprim ndaj fëmijëve.....	25
2.4.	Mbrojtësi.....	26
2.5.	Qendra për punë sociale.....	27

Kapitulli III

3. MASAT PËR SIGURIM TË PREZENCËS SË FËMIJËS DHE ZHVILLIMI I PROCEDURËS PENALE NDAJ FËMIJËVE

3.1.	Thirrja.....	28
3.2.	Mbajtja.....	29
3.3.	Paraburgimi afatshkurtër.....	31
3.4.	Paraburgimi.....	31
3.5.	Inicimi i procedurës.....	34
3.6.	Procedura përgaditore ndaj fëmiut.....	35
3.7.	Procedura para Këshillit për fëmijë.....	38
3.8.	Vendimet e Këshillit për fëmijë.....	40
3.9.	Mjetet juridike.....	40

3.9.1. Ankesa si mjet i rregullt juridik.....	41
3.9.2. Mjetet e jashtëzakonshme juridike.....	42

Kapitulli IV

4. NUMRI I FËMIJËVE TË GJYKUAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT: 2012-2017 DHE STUDIM I RASTEVE INDIVIDUALE NGA KRIMINALITETI I FËMIJËVE

4.1. Numri i fëmijëve të paraqitur: 2012-2017 në RMV.....	43
4.2. Numri i fëmijëve të akuzuar: 2012-2017 në RMV.....	44
4.3. Numri i fëmijëve të gjykuar: 2012-2017 në RMV.....	45
4.4. Vendime gjyqësore nga Gjykata Themelore e Tetovës.....	46
4.5. Rasti 1 : Vrasje.....	46
4.6. Rasti 2 : Vjedhje Rendë.....	48
4.7. Rasti 3 : Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prokusorëve.....	50
4.8. Rasri 4 : Vrasje.....	51
4.9. Rasti 5 : Grabitje.....	55
Përfundime.....	59
Bibliografia	61

HYRJE

1. Lënda e hulumtimit

Lënda e këtij hulumtimi përfshinë tema të cilat e trajtojnë pozitën e fëmijës në ndesh me ligjin, ndaj të cilit zhvillohet procedurë penale. Në kuadër të kësaj teme do të trajtohen këto tema, të cilat më hollësisht janë apraqitur në pjesën nr. 6 “Strukturimi i punimit”, si vijon:

Karakteristikat, burimet dhe parimet në procedurë penale ndaj fëmijës në ndesh me ligjin, sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Maqedonisë së Veriut; Subjektet në procedurën penale ndaj fëmijës; Masat për sigurim të prezencës së fëmijës; Zhvillimi i procedurës penale ndaj fëmijëve; Numri i fëmijëve të gjykuar në R:M.V. 2013-2018 dhe studimi rasteve nga kriminaliteti i fëmijëve bazuar në praktikën gjyqësore të vendit.

2. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit të temës “Pozita e fëmijëve në ndesh me ligjin në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut” është të trajtojë rregullimin e zhvillimit të procedurës së rregullt penale ndaj fëmijëve sipas legjislacionit pozitiv të vendit.

Duke marrë parasyshë faktin se sistemi i drejtësisë për fëmijë paraqet një sistem të veçantë nga ai për persona madhorë kryerës të veprave penale, edhe qëllimi i këtij hulumtimi është të

studiojë pozitën e veçantë të cilën e gëzojnë fëmijët kryerës të veprave penale për dallim nga ata madhorë.

Fëmijët kanë trajtim më të butë sesa madhorët dhe atë në të tri degët e sistemit të drejtësisë për penale për fëmijë, si atë materiale, procedurale dhe atë mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, kjo sepse qëllimi i këtij sistemi të së drejtës është riedukimi, socializimi dhe zhvillimi i drejtë i fëmijës – i shprehur në Ligjin mbi drejtësinë për fëmijë.

Pasiqë parimet e përcaktuara në Ligjin mbi drejtësi për fëmijë përcaktojnë se procedura gjyqësore duhet të jetë mjeti i fundit për veprim me fëmijët krahas procedurave të tjera të veçanta jogjyqësore të cilat zhvillohen nga organe të specializuara, ky fakt parqet një sfidë për hulumtim të pozitës së fëmijës gjatë të gjitha fazave të procedurës së rregullt gjyqësore.

Megenëse Ligji mbi drejtësinë për fëmijë përcakton se organet dhe subjektet tjerë proceduralë të cilët veprojnë në procedurë ndaj fëmijës duhet të kenë specializim të veçantë, duke poseduar njohuri nga sfera e të drejtave të fëmijëve dhe delikuenca e fëmijëve (Seksion të specializuar gjyqësor për kriminalitetin e fëmijëve të formuar në gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar të përbërë nga gjykatës për fëmijë, këshilla për fëmijë dhe këshillues për fëmijë). Rol themelor kanë edhe Qendrat për punë sociale, prokuroria Publike, Ministria e punëve të Brendshme dhe entet për ekzekutimin e sanksioneve penale për fëmijë. Këto organe sipas Ligjit për drejtësinë e fëmijëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2013). janë të obliguara që së paku pesë ditë brenda viti të ndjekin trajnime për drejtësinë për fëmijë në vend apo jashta vendit. Gjithë jo tregon se pozita e kategorisë së “fëmijëve në ndesh me ligjin” ndaj të cilëve zhvillohet ky proces është unike, e veçantë në krahasim me pozitën e personave madhorë të pandehur.

3. Hipotezat

Hipotezat e parashtruara të punimit janë:

1. Qëllimi themelor i procedurës penale ndaj fëmijës në ndesh me ligjin është riedukimi, risocializimi dhe zhvillimi i drejtë i fëmijës. Poashtu edhe eliminimi i shkaqeve të cilat e kanë shtyrë fëmijun drejtë rrugës së sjelljes delikuyente, me ç'rast shqiptimi i dënimit për veprën e kryer është mjet i fundit që e zbaton gjykata.
2. Procedura penale ndaj fëmijëve në ndesh me ligjin i ka specifikat e veta të cilat e bëjnë atë të dallohet nga procedura gjyqësore e cila zbatohet ndaj të pandehurve të moshës madhore. Duke filluar nga ligji i veçantë i cili e rregullon procedurën ndaj fëmijëve, specializimi i organeve dhe subjekteve të clët marrin pjesë në procedurë, të cilët posedojnë njohuri të veçanta nga sfera e drejtësisë për fëmijëve dhe delikuenca e fëmijëve
3. Pozita e fëmijëve në ndesh me ligjin është e veçantë në krahasim me atë të personave të moshës madhore sepse veprimi me fëmijë në procedurë penale mundëson qasje individuale të përshtatur drejtë natyrës, intensitetit dhe zgjatjes së intervenimeve, rrezikut nga përsëritja, moshës dhe shkallës së pjekurisë së fëmijës.
4. Tendenca e legjislacionit pozitiv për drejtësinë ndaj fëmijëve tregon se masat edukuese si sanksione penale kanë një vend dominant dhe theksim të intervenimit në krahasim me sanksionet që kanë për pasojë privim nga liria të fëmijës në ndesh me ligjin.

4. Metodologjia e hulumtimit

Gjatë këtij hulumtimit do të përdoren metoda të ndryshme, si:

- Metodologjia *teorike* (Metoda juridike; Metoda historike; Metoda krahasuese; Metoda sociologjike; Metodatat psikologjike dhe logjike), dhe
- Metodologjia *empirike* (Metoda statistikore; Metoda e analizës dhe sintezës;; Metoda e vështimit dhe metoda përshkruese).

Hulumtimi do të bazohet në të dhëna nga autorë kompetentë të cilët kanë trajtuar të drejtën penale për fëmijë. Do të respektohen rregullat e shfrytëzimit të njohurive deri tek të cilat do të arrihet. Poashtu do të respektohet rendi shtëpiak në të gjitha institucionet që do të vizitohen gjatë hulumtimit shkencor. Materiali faktografik që do të përdoret do të konsistojë në sigurimin e rezultateve të nevojshme lidhur me rastet nga praktika gjyqësore lidhur me fëmijë të gjykuar si dhe të dhënat zyrtare nga Enti shtetëror statistikor i RMV-së lidhur me numrin e fëmijëve të paraqitur, të akutuar dhe të gjykuar në vend gjatë periudhës kohore 2013-2018.

5. Rëndësia e punimit

Hulumtimi i temës “Pozita e fëmijëve në ndesh me ligjin në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut” paraqet një studim i cili do të nxjerrë në pah specifikat e drejtësisë penale ndaj fëmijëve, përkatësisht të asaj procedurale penale bazuar në legjislacionin pozitiv të vendit tonë.

Ligji për drejtësinë për fëmijë i Republikës së Maqedonisë së Veriut rregullon rrjedhën e procedurës penale ndaj fëmijëve në ndesh me ligjin si dhe procedurat e veçanta jogjyqësore të cilat zhvillohen nga ana e organeve të specializuara.

Ky hulumtim do të fokusohet vetëm në trajtimin e procedurës së rregullt gjyqësore e cila zhvillohet ndaj kategorisë së fëmijëve “në ndesh me ligjin”, për të nxjerrë në pah karakteristikat dhe specifikat të cilat e dallojnë këtë proces nga ai i cili zhvillohet ndaj të pandehurve të moshës madhore.

Tendencat bashkëkohore të veprimit me fëmijë përcillen nga dispozitat të cilat dalin nga dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare për drejtësinë për fëmijë, siç janë Konventa Evropjane për të drejtat e fëmijës, dokemnte të OKB-së si dhe rekomandime të KE-së. Si rezultat i tendencës së këtyre instrumentave ndërkombëtare edhe ligjislacioni pozitiv i vendit tonë i cili rregullon procedurën penale ndaj fëmijëve dhe drejtësinë ndaj fëmijëve në përgjithësi paraqet një sistem të përbërë nga dy komponenta: Drejtësi për fëmijët dhe mirëqenie të fëmijëve.

6. Strukturimi i punimit

Punimi hulumtues është i përbërë nga gjithsej katër kapituj. Kapitulli i parë i emërtuar Karakteristikat, burimet dhe parimet në procedurën ndaj fëmijës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, trajton këto tema: Përkufizimi i nocionit fëmijë dhe kategorizimi i fëmijëve sipas Ligjit për drejtësinë për fëmijë; Moshë minimale për përgjigjësi penale bazuar në legjislacionin pozitiv të RMV-së; Karakteristikat e të drejtës penale ndaj fëmijëve;

Burimet e të drejtës penale ndaj fëmijëve; Parimet e veprimit me fëmijë dhe parimet themelore të procedurës gjyqësore ndaj fëmijëve.

Në kapitullin e dytë të emërtuar “Subjektet në procedurën penale ndaj fëmijës”, trajtohen këto tema: Këndvështrim i përgjithshëm ndaj subjekteve procedurale; Gjykata kompetente në procedurë ndaj fëmijëve; Prokurori publik për veprim ndaj fëmijëve; Mbrojtësi dhe Qendra për punë sociale.

Në kapitullin e tretë të emërtuar “Masat për sigurim të prezencës së fëmijës dhe zhvillimi i procedurës penale ndaj fëmijëve”, trajtohen temat si në vijim: Thirrja, Garancioni; Shoqërimi; Mbajtja; Paraburgimi afatshkurtër; Paraburgimi; Inicimi i procedurës; Procedura përgaditore ndaj fëmiut; Procedura para Këshillit për fëmijë; Vendimet e Këshillit për fëmijë; Mjetet juridike; Ankesa si mjet i rregullt juridik dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Kapitulli i fundit, me emërtim “ Numri i fëmijëve të gjykuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe studim i rasteve individuale nga kriminaliteti i fëmijëve”, përbanë të dhëna statistikore nga Enti shtetëror statistikor, për numrin e fëmijëve të paraqitur, akuzuar dhe gjykuar për periudhën 2012-2017 si dhe analizim të Vendimeve gjyqësore nga Gjykata themelore – Tetovë të rasteve të gjykuara ndaj fëmijëve për vepra penale.

Kapitulli I

1. KARAKTERISTIKAT, BURIMET DHE PARIMET NË PROCEDURËN NDAJ FËMIJËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

1.1. Përkufizimi i nocionit fëmijë dhe kategorizimi i fëmijëve sipas Ligjit mbi Drejtësinë për fëmijë

Kategoria e *fëmijëve që bien ndesh me ligjin nga moshë 14-18 vjeçare* kanë përgjegjësi penale në rast të kryerjes së ndojë veprë të kundërligjshme (neni 19) dhe vetëm ndaj kësaj kategorie fëmijësh mund të shqiptohen sanksione penale nga një procedurë penale.

Neni 19 i këtij ligji i kategorizon fëmijët si vijon:

- **Fëmijë** është ç'do person deri në moshën 18 vjet;
- **Fëmijë në rrezik** është ç'do fëmijë që i ka mbushur shtatë vjet dhe nuk i ka mbushur 18 vjet me pengesa trupore ose pengesa të zhvillimit mental, viktimë e dhunës, i lënë pas dore nga aspekti edukues dhe social, i cili gjendet në gjendje të atillë në të cilën është penguar ose është pamundësuar realizimi i funksionit edukues i prindit/ëve ose tutorit/ëve, i cili nuk është përfshirë në sistemin e arsimimit dhe edukimit, i përfshirë në lypësi, endje ose prostitucion, i cili përdor droga dhe substanca tjera psikotropike dhe prekursorë ose alkool, e i cili për shkak të gjendjeve të këtilla është ose mund të bie ndesh me ligjin si viktimë ose si dëshmitar i veprimit që me ligj është paraparë si kundërvajtje ose veprim që me ligj është paraparë si vepër penale;
- **Fëmijë në rrezik deri në moshën 14 vjet** është ç'do fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprës së paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose burg mbi tri vite ose vepër e paraparë me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur shtatë vjet, e nuk i ka mbushur 14 vjet;
- **Fëmijë në rrezik nga 14 deri 18 vjet** është ç'do fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit, të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose dënim me

burg deri në tri vite ose vepër e paraparë me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet;

- **Fëmijë që bie ndesh me ligjin nga 14 deri 16 vjet** është ç'do fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi tri vite, i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 16 vjet;
- **Fëmijë që bie ndesh me ligjin mbi 16 vjet** është ç'do fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi tri vite, i ka mbushur 16 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet;
- **Fëmijë viktimë** është ç'do fëmijë i moshës deri 18 vjet i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë lëndim fizik ose mental, pësime emotive, humbje materiale ose shkelje tjetër ose rrezikim të të drejtave dhe interesave si pasojë e veprimit të kryer me ligj të paraparë si vepër penale;
- **Person i ri i moshës madhore** është personi i cili gjatë kohës së gjykimit për veprim të paraparë me ligj si vepër penale, i ka mbushur 18 vjet e nuk i ka mbushur 21 vjet.

1.2. Mosha minimale për përgjegjësi penale bazuar në legjislacionin pozitiv të RMV

Mosha e tillë proklamohet edhe në ligjin pozitiv për drejtësinë e fëmijëve: "***Ndaj fëmijës i cili në kohën e kryerjes së veprës e cila me ligj është parashikuar si vepër penale nuk ka mbushur 14 vjet, nuk mund të aplikohen sanksionet e përcaktuara me këtë ligj***" (neni 20), nga i cili parim përcaktohet kufiri minimal i moshës së fëmijëve lidhur me përgjegjësinë penale. Të gjitha ligjet penale të Republikës të Maqedonisë kanë përcaktuar kufirin e përgjegjësisë penale nga mosha mbi 14 vjeç dhe përfundimin e miturisë me moshën 18 vjet.

Pra, vetëm kategoria e *fëmijëve që bien ndesh me ligjin nga mosha 14-18 vjeçare* kanë përgjegjësi penale në rast të kryerjes së ndojë veprë të kundërligjshme (neni 19) dhe vetëm ndaj kësaj kategorie fëmijësh mund të shqiptohen sanksione penale nga një procedurë penale.

Mendoj se Republika e Maqedonisë duhet të vazhdojë t'i përmbahet këtij përcaktimi të kufirit të moshave – minimale dhe maksimale të fëmijëve, sepse kjo gjë është në pajtim me kriteret e kërkuara nga Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës. Veçanërisht konsideroj se nuk duhet

të ulet mosha minimale për përgjegjësi penale të fëmijëve (14 vjeçare), duke marrë parasysh shumë faktorë objektivë të cilët lidhen me kushtet që ofrohen gjatë ekzekutimit të sanksioneve penale për fëmijë në vendin tonë.

1.3. Karakteristikat e të drejtës penale ndaj fëmijëve

Drejtësia penale për fëmijë e Republikës së Maqedonisë nga pavarësimi i saj (në vitin 1991) deri më sot (2018) ka pësuar disa herë ndryshime të cilat kanë sjellur reforma në të drejtën penale për fëmijë. Historikisht, këto janë ligjet të cilat e kanë rregulluar trajtimin juridiko-penal të fëmijëve në konflikt me ligjin: Ligji penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1976)¹ dhe Ligji Penal i Republikës Socialiste të Maqedonisë (1976)²; Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë (1996)³; Ligji mbi drejtësinë e të miturve (2007)⁴ dhe Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve (2013)^{5, 6}.

Ligji i fundit pozitiv që rregullon drejtësinë penale për fëmijë është Ligji mbi drejtësinë për fëmijë i vitit 2013. Ky ligj rregullon në mënyrë të detajuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e fëmijëve që janë në konflikt me ligjin apo përfaqësojnë viktimat e krimit. Përveç kategorizimit të fëmijëve në ndarje të caktuara sipas moshës dhe cilësive, ky ligj parasheh të gjitha llojet e sanksioneve penale dhe përcakton kushtet nën të cilat mund të shqiptohen ato ndaj fëmijëve kryes të veprave penale dhe kundërvajtëse. Ai rregullon edhe sanksionimin e personave të moshës madhore për veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale të cilat i

¹ Ligji penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, "Gazeta Zyrtare e R.S.F.J." nr. 44/76, 34/84, 74/84, 57/89, 3/90, 38/90 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 25/92 and 32/93.

² Ligji penal i Republikës Socialiste të Maqedonisë "Gazeta Zyrtare. e R.S.M." nr. 25/77, 23/84, 50/87, 36/89, 7/90, 23/91, 24/92, 49/93.

³ Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr: 37/1996.

⁴ Ligji mbi drejtësinë e të miturve i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 87/2007, 103/2008, 161/2008, 145/2010. Nga dita e fillimit me zbatimin e këtij ligji pushojnë të vlejnjë dispozitat nga neni 70 deri 96 nga Kodi penal i R.M. "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006 dhe 73/2006 që rregullonin trajtimin juridiko-penal të të miturve.

⁵ Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013. Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji u shfuqizua Ligji mbi drejtësinë e të miturve. Ky ligj filloi të zbatohet nga 1 dhjetori 2013 dhe aktualisht është ligji pozitiv i cili zbatohet për drejtësinë e fëmijëve.

⁶ Blerta A.Arifi, Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës kohore 2006-2015, UEJL, Tetovë, fq.21

kanë kryer si fëmijë; Sanksionet për fëmijë për vepra kundërvajtëse; Përcakton edhe llojet dhe mënyrën e zbatimit të masave jopenale – Masave të ndihmës dhe mbrojtjes të cilat së bashku me të gjitha llojet e masave represive që i parasheh ligji kanë qëllim edukimin, socializimin, zhvillimin e drejtë dhe mbrojtjen e interesave të fëmijës. Ligji përmban edhe dispozita mbi procedurën penale për fëmijë dhe procedurën e ndërmjetësimit. Poashtu Ligji mbi drejtësinë për fëmijë përmban dispozita rreth parandalimit të delikuencës së fëmijëve.⁷

- **Sistemi i të drejtës penale ndaj fëmijëve është përbërë nga:**

1. E drejta penale materiale- sistem i dispozitave ligjore me të cilat rregullohet statusi penalo-juridik i fëmijëve kryerës të veprave penale dhe sistemit sanksioneve penale, masave alternative dhe masave siguruese të cilat mund të iu shqitohen fëmijëve të cilët janë kryerës të veprave penale;⁸
2. E drejta penale procedurale- sistem i dispozitave ligjore me të cilat caktohet nocioni, organizimi dhe kompetenca e organeve në gjyqësorin penal ndaj fëmijëve, iniciimi dhe zhvillimi i procedurës penale dhe procedura me mjete juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme;⁹
3. E drejta mbi ekzekutimin e sanksioneve penale- sistem i dispozitave ligjore dhe nënligjore me të cilat përcaktohet organizimi dhe kompetenca e organeve shtetërore kompetente për ekzekutim të sanksioneve penale ndaj fëmijëve, masave alternative dhe masave siguruese dhe procedura e ekzekutimit të tyre.¹⁰

⁷ Blerta A.Arifi, Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës kohore 2006-2015, UEJL, Tetovë, fq.24

⁸ Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015 G. Кривично постапување со деца во ризик и во судир со законот, 2015, f.111

⁹ Po aty

¹⁰ Po aty.

1.4. Burimet e të drejtës penale ndaj fëmijëve

Burimet e të drejtës penale ndaj fëmijëve ndahen në: Të brendshme dhe ndërkombëtare. Ato të brendshmet ndahen në :

- Kushtetuese, ligjore dhe nënligjore;
- Kryesore dhe plotësuese.¹¹

1.4.1. *Burime kryesore të brendshme* janë:

- Kushtetuta e R.M.-së (Gazeta zyrtare e R.M. nr.52 nga data 22.11.1992 me Amandamentet plotësuese);
- Ligji mbi drejtësinë për fëmijë (Gazeta zyrtare e R.M. nr 148/2013) dhe
- Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve (Gazeta zyrtare e R.M. nr.02/2006, 57/2010 dhe 170/2013).¹²

1.4.2. *Burime plotësuese të brendshme* janë:

- Kodi penal i R.M.-së (Gazeta zyrtare e R.M. nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014 dhe 199/2014);
- Ligji për procedurë penale (Gazeta zyrtare e R.M. nr.150/2010 dhe 100/2012) dhe
- Deklarata për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës (e ratifikuar në vitin 2003), si dhe ligje të tjera.¹³

¹¹ Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f.114

¹² Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f.115

¹³ По ату.

1.5. Parimet e veprimit me fëmijë

1.5.1. Parime të përgjithshme

- Parimi i ligjshmërisë- Fëmijës mbi moshën 14 vjet **nuk mund** t'i shqiptohet **sanksion për veprën** e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e paraparë **me ligj** si vepër penale ose si kundërvajtje dhe për të cilën nuk është përcaktuar sanksion me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare (n. 5); ¹⁴
- Prezumimi i pafajsisë- Fëmijës mbi moshën 14 vjet në veprimin joformal të organeve dhe shërbimeve kompetente, si dhe në procedurën gjyqësore, i **garantohen të drejtat** e njëjta që i kanë personat e moshës madhore të akuzuar në procedurë penale ose kundërvajtëse, si dhe të drejtat e veçanta të pranura me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe marrëveshjet tjera të ratifikuara, në të gjitha fazat e procedurës dhe në shqiptimin e cilitdo sanksioni ose mase të paraparë me ligj. Nuk mund të konsiderohet se fëmija bie ndesh me ligjin derisa kjo nuk përcaktohet me **vendim të plotfuqishëm gjyqësor**. Gjatë veprimit gjykatat dhe institucionet tjera në zbatimin e dispozitave të Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë, qëllim kryesor e kanë realizimin e **interesave më të mira** për fëmijun (n. 7); ¹⁵
- Ndalimi i diskriminimit - **Gjykata dhe institucionet tjera** në zbatimin e Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë i respektojnë dhe i sigurojnë të drejtat e fëmijës **pa asnjë diskriminim**, pa dallim të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë së grupit të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, origjinës sociale, religjionit ose besimit fetar, llojeve tjera të besimit, shkollimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, pengesave mentale dhe trupore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore ose çfarë do qoftë tjetër përveç asaj që është paraparë me ligj ose marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, të prindit/ëve, ose tutorit/ëve ose të anëtarëve të familjes së fëmijës. Gjykata dhe institucionet tjera gjatë zbatimit të këtij ligji i ndërmarrin të gjithë masat e nevojshme për sigurimin e mbrojtjes së fëmijës nga të gjitha llojet e diskriminimit ose sanksionit ose kufizimeve tjera të të

¹⁴ Ligji për drejtësinë për fëmijë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013, neni 5

¹⁵ Ligji për drejtësinë për fëmijë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013, neni 7

drejtave në bazat e parapara në parag.1 të këtij neni (n. 8);¹⁶

- Ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor e çnjerëzues- Asnjë fëmijë **nuk guxon** t'i ekspozohet **mundimit, veprimeve ose sanksioneve tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese**. Fëmiu ç'do herë ka të drejtë për mbrojtje të përforcuar nga mundimi dhe veprimet ose sanksionet tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese (n. 9);¹⁷
- Specializimi i organeve kompetente- Procedurën ndaj fëmijës e zhvillon dhe sanksionet e përcaktuara me këtë ligj i shqipton vetëm **gjykata kompetente**. Masa tjera të parapara me këtë ligj mund të shqiptojnë edhe **organet tjera të specializuara** (n. 18).¹⁸

1.5.2. Parimet themelore të procedurës gjyqësore ndaj fëmijëve

1.5.3. Parimi i oficialitetit- Në procedurë për veprime që me ligj janë të parapara si vepra penale paditës i autorizuar është vetëm prokurori publik.¹⁹ Oficialiteti nënkupton se fillimi dhe zhvillimi i procedurës bëhet vetëm sipas kërkesës së prokurorit publik.²⁰ Parimi i oficialitetit është ngushtë i lidhur me parimin e specializimit të organeve kompetente në procedurë. Për veprime të cilat me ligj janë të parapara si vepra penale të cilat ndiqen me propozim ose padi private, procedurën mund të inicohet nëse i dëmtuari në afat prej tre muajsh nga njohuria për veprën e kryer ose kryerësin, paraqet propozim për inicim të procedurës para prokurorit publik kompetent. Në rastet kur prokurori publik nuk do të parashtrojë kërkesë për inicim të procedurës ndaj fëmiut, është i obliguar për këtë ta njoftojë të dëmtuarin. I dëmtuari nuk mund ta ndërmerr procedurën në cilësi të paditësit subsidiar, përkatësisht nuk mund të parashtrojë padi private deri në gjyq, por vetëm mundet që në afat prej tetë ditësh nga pranimi i njoftimit

¹⁶ Ligji për drejtësinë për fëmijë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013, neni 8

¹⁷ Ligji për drejtësinë për fëmijë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013, neni 9

¹⁸ Ligji për drejtësinë për fëmijë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013, neni 18

¹⁹ Ligji për drejtësinë për fëmijë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013, neni 89

²⁰ Buzharovska, G.L., Nanëv, L., Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f.125

nga ana e prokurorit publik të kërkojë nga këshilli për fëmijë i gjykatës kompetente për të vendosur lidhur me inicimin e procedurës penale.²¹

1.5.4. Parimi i përshtatshmërisë dhe oportunitetit- Ky parim nënkupton autorizimin e prokurorit publik për të mos inicuar procedurë penale ndaj fëmiut të paraqitur për kryerje të veprës penale edhe në raste kur ekzistojnë prova se fëmiu e ka kryer veprën penale.

Autorizimet e prokurorit publik mund të ndahen në tri grupe²²:

- a. E drejta e vlerësimit të përshtatshmërisë për ndjekjen penale të fëmiut mbi 14 vjet pas kallëzimit penal për veprim që me ligj parashihet si vepër penale e për të cilin është paraparë dënim me para ose dënim me burg deri në 3 vite, si dhe në rast kur duhet të inicohet procedurë ndaj fëmiut i cili gjendet në vuajtje të dënimit ose masës edukuese, pa marrë parasyshë rëndësinë e veprës penale;
- b. E drejta e prokurorit publik në marrëveshje me Qendrën për punë sociale²³ për ta udhëzuar fëmiun në strehimore ose ent edukues e cila mund të zgjasë më së shumti një muaj, si dhe për vepër penale për të cilën parashihet dënim me burgim prej së paku 5 vite të merr vendim për të mos inicuar procedurë në afat prej 30 ditësh edhe pse ekzistojnë prova se fëmiu e ka kryer veprën penale- nëqftë se vlerëson se nuk do të ishte e përshtatshme të zhvillohet procedura marrë në konsideratë natyrën e veprës penale dhe rrethanat nën të cilat është kryer, jetën e mëparshme të fëmiut si dhe personalitetin e tij.

1.5.5. Të drejtën e vërtetimit të rrethanave të cilat lidhen me jetën e mëparshme të fëmiut si dhe cilësitë personale të tij, si dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale.

²¹ Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f.125-126

²² Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, 2015, f.127

²³ Ligji mbi drejtësinë për fëmijë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013, neni 75

1.5.6. Parimi i shpejtësisë – Sipas këtij parimi secili veprim ndaj fëmijëve nga ana e gjykatës dhe organeve të tjera duke i zbatuar dispozitat e Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë duhet të zgjasë dhe të përfundojë në afat të arsyeshëm, i cili nuk do të shkaktojë dëm interesave të fmiut.²⁴

1.5.7. Përjashtim i detyrueshëm i publikut – Gjykata dhe organet e tjera të cilat marrin pjesë në procedurën ndaj fëmiut janë të obliguar të sigurojnë mbrojtje të privatësisë së fëmiut dhe familjes së tij.²⁵ Në procedurë ndaj fëmiut publiku është i kufizuar, pra mund të marrin pjesë vetëm prindërit/kujdestarët e fëmiut si dhe me leje të këshillit për fëmijë mund të marrin pjesë personatë cilët punojnë në sferën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pranë Avokatit të popullit, persona që punojnë në sferën e mbrojtjes dhe edukimit të fëmijëve, persona të afërt të fëmiut, përfaqësues të organizaave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si dhe puntorë shkencorë.²⁶

1.5.8. Ndalesa e gjykimit të fëmijës në mungesë- Pjesëmarrja e fëmiut në procedurën penale e cila zhvillohet kundër tij është kusht i domosdoshëm për tu zhvilluar procedura. Ndalohet gjykimi i fëmiut në mungesë.²⁷ Sipas nenit 88 të Ligji mbi drejtësinë për fëmijë kur fëmiu nuk do të jetë i kapshëm për gjyqin, gjyqi sjell vendim për ndërprerje të procedurës. Në këtë rast afatet ndalojnë të rrjedhin përderisa fëmiu është i pakapshëm, por jo më gjatë se mbushja e moshës 27 vjeçare e kryerësit. Procedura pushon sipas detyrës zyrtare.²⁸

- Parimi i mbrojtjes procedurale- Sipas këtij parimi organet procedurale që veprojnë me fëmiun janë të obliguara që ta kenë parasysh qëllimin e procedurës – mbrojtjen e fëmijëve kryerës të veprave penale dhe kundërvajtjeve, socializimin e tyre, edukimin dhe riedukimin, ndihmën dhe përkujdesjen për fëmijët si dhe mbrojtjen gjatë procedurës para gjyqit dhe organeve të tjera.²⁹ Privimi i fëmijës nga liria zbatohet vetëm si mjet i fundit në procedurë, dhe

²⁴ Ligji mbi drejtësinë për fëmijë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013, neni 11.

²⁵ Ligji mbi drejtësinë për fëmijë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013, neni 91

²⁶ Ibid, neni 92

²⁷ Ibid, neni 93, p.1

²⁸ Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f.127

²⁹ Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f.133

vetëm në kushte dhe në kohëzgjatje të përcaktuar me Ligji mbi drejtësinë për fëmijë. Gjatë vendosjes për zbatimin e masave dhe sanksioneve të përcaktuara me Ligjin mbi drejtësinë për fëmijë, ç'do herë u jepet përparësi masave preventive, mbrojtëse dhe edukuese.³⁰

³⁰ Ligji mbi drejtësinë për fëmijë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013, neni 10 dhe 15

Kapitulli II

2. SUBJEKTET NË PROCEDURËN PENALE NDAJ FËMIJËS

2.1. Këndvështrim i përgjithshëm ndaj subjekteve procedurale

Procedura penale përbëhet prej një mori veprimesh procedurale të ushtruara sistematikisht nga ana e organeve shtetërore dhe personave tjerë. Andaj, organet apo personat të cilët krzejnë veprime procedural në procedurë penale i quajmë subjekte të proeurës penale të cilët kanë të drejta dhe detyra të caktuara.³¹ Duke e pasur parasysh faktin se të gjitha veprimet procedural nuk janë të një rëndësie të njejtë, dhe meqë disa prej tyre drejtëpërdrejtë kanë të bëjnë me realizimin e funksioneve themelore të procedurës, ndërsa të tjerat i shërbejnë nevojave procedural, edhe pjesëmarrësit e procedurës penale i ndajmë në subjekte themelore dhe pjesëmarrës tjerë të procedurës penale.³²

Subjekte në procedurë penale janë personat dhe organet të cilët ndërmarrin veprime të caktuara procedurale sipas pozitës procedurale që e kanë dhe paraqiten si bartës të të drejtave dhe obligimeve të caktuara gjatë rrjedhës së procedurës penale. Në procedurën penale ndaj fëmijëve, si subjekte kryesore paraqiten gjykata, prokurori publik dhe fëmiu në cilësi të të pandehurit. Prokurori publik dhe fëmiu në cilësi të të pandehurit janë palë në procedurën penale.³³

Avokati si mbrojtës i fëmiut nuk është palë, por pjesëmarrja e tij në procedurë është obligatore.³⁴ Procedura penale ndaj fëmiut në cilësi të të pandehurit është e veçantë për shkak të specifikës që e ka në kuptim të rolit të veçantë të cilin e ka në këtë procedurë Qendra për punë sociale, e cila paraqet një pjesëmarrës të specializuar procedural pa veprimet e të cilit procedura ndaj fëmiut as që mund të fillojë, apo të vazhdojë e të përfundojëme një aktgjykim

³¹ Sahiti E., Zejneli I. E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, UEJL, Fakulteti i Drejtësisë, Shkup, 2017, f. 67

³² Sahiti E., Zejneli I. E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, UEJL, Fakulteti i Drejtësisë, Shkup, 2017, f. 67

³³ Buzharovska, G.L., Nanev, L., Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, fq. 162

³⁴ Ibid.

të ligjshëm dhe të drejtë.³⁵ Idëmtuari, dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe personat tjerë të cilët marrin pjesë gjatë rrjedhës së procedurës penale paraqesin pjesëmarrësit tjerë në procedurë.³⁶

2.2. Gjykata kompetente në procedurë ndaj fëmijëve

Procedura gjyqësore zhvillohet ndaj fëmiut në konflikt me ligjin të moshës 14 deri 18 vjeçare, për veprim që me ligj është i paraparë si vepër penale ose kundërvajtje.³⁷ Kur gjatë zhvillimit të procedurës penale do të vërtetohet se fëmiu gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është i paraparë si veprë penale nuk i ka mbushur 14 vjet, procedura do të pushohet dhe tër këtë do të njoftohet Qendra për punë sociale, e cila më pastaj do të veprojë në pajtim me dispozitat për veprim me fëmijë në rrezik.³⁸ Në procedurë ndaj fëmiut, nëse me Ligjin mbi drejtësinë për fëmijë nuk është e rregulluar ndryshe, zbatohet dispozitat e Ligjit të procedurës penale dhe Ligjit për kundërvajtje.³⁹ Dispozitat e Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë zbatohen edhe ndaj personave që kanë kryer veprim që me ligj është parapara si vepër penale si fëmijë, e në kohën e ngritjes së procedurës, ose gjykimit i kanë mbushur 21 vjet, si dhe në procedurë ndaj fëmijës në rrezik mbi 14 vjet që nuk i ka mbushur 21 vjet, nëse deri në fillimin e shqyrtimit kryesor vërtetohet se atij personi mund t'i shqiptohen sanksione për fëmijë.⁴⁰

Dallimi kryesor mes gjykatave të cilat gjykojnë në procedure penale ndaj personave madhore dhe atyre ndaj fëmijëve është specializimi i tyre. Ligji mbi drejtësinë për fëmijë kërkon specializim të obligueshëm të gjykatave në procedurë ndaj fëmijëve. Gjykatësi për fëmijë, prokurori publik, avokati dhe personat e autorizuar zyrtarë nga Ministria e Punëve të

³⁵ Ibid.

³⁶ Ibid.

³⁷ Buzharovska, G.L., Nanev, L., Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, fq. 163

³⁸ Ligji për drejtësinë për fëmijë, nenet 24-32

³⁹ Buzharovska, G.L., Nanev, L., Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, fq. 163

⁴⁰ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.86, p.2

Brendshme, së paku pesë ditë gjatë vitit ndjekin trajnim të specializuar për drejtësi për fëmijë në vend dhe jashtë vendit.⁴¹

Seksionet e specializuara gjyqësore për kriminalitetin e fëmijëve të formuara në gjykata themelore me kompetencë të zgjeruar, përbëhen nga gjykatës për fëmijë, këshilla për fëmijë dhe këshilltarë për fëmijë. Gjykatësi për fëmijë e zbaton procedurën përgatitore, miraton vendime në pajtim me nenin 86 të këtij ligji, kryeson me këshillin për fëmijë dhe kryen punë tjera të përcaktuara me këtë ligj.⁴²

Në seksionet e specializuara gjyqësore për drejtësi për fëmijë, të formuara në gjykata themelore me kompetencë të zgjeruar, për kryerjen e punëve profesionale, kryetari i gjykatës cakton nga një punëtor social, pedagog ose psikolog me propozim të qendrës. Punëtorët profesionalë u ndihmojnë gjykatësit për fëmijë dhe këshillit për fëmijë në udhëheqjen e procedurës përgatitore dhe shqyrtimit, japin mendime profesionale lidhur me vendimin e gjykatës dhe sanksionin që do të duhej të shqiptohet në rastin konkret, i ndihmojnë gjykatës në mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve të shqiptuara dhe japin propozime për ndërprerjen e zbatimit ose zëvendësimit të një sanksioni me tjetër.⁴³

Për procedurën ndaj fëmijës kompetent vendor sipas rregullës është gjykata e vendbanimit të tij, e nëse fëmija nuk ka vendbanim të përhershëm ose nëse ai është i panjohur, gjykata e vendqëndrimit të fëmijës.

(2) Procedura mund të zbatohet para gjykatës së vendqëndrimit të fëmijës ose para gjykatës së vendit të kryerjes së veprimit që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje, në rastet kur është e qartë se para asaj gjykate procedura do të zbatohet pa prolongim.⁴⁴

Gjykata dhe organet tjera që marrin pjesë në procedurë janë të obliguar që të sigurojnë mbrojtjen e privatësisë së fëmijës dhe familjes së tij. Kur gjykohet fëmija, gjithmonë përjashtohet publiku.⁴⁵ Fëmija nuk mund të gjykohet në mungesë. Gjatë parashtrimit të argumenteve të veçanta ose të fjalimit të palëve, gjykata mund të urdhërojë që fëmija të

⁴¹ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013., n. 101, p.3

⁴² Ibid, n. 101. p.1, 2

⁴³ Ibid, n.104, p.1, 3

⁴⁴ Ibid, n.105

⁴⁵ Ibid, n.91

largohet nga shqyrtimi. Gjatë marrjes së veprimeve ku është prezent fëmija e veçanërisht gjatë marrjes së tij në pyetje, organet që marrin pjesë në procedurë janë të obliguar që të veprojnë me kujdes, duke marrë parasysh zhvillimin shpirtëror, ndjeshmërinë dhe vetitë personale të fëmijës, që të mos ndikojë dëmshëm mbajtja e procedurës në zhvillimin e fëmijës. Fëmija merret në pyetje në mënyrë që i përgjigjet moshës së tij, rrethanave të rastit dhe gjendjes së tij psikofizike.⁴⁶

Këshilli për fëmijë i gjykatës së apelit, i përbërë nga gjykatësi për fëmijë dhe dy gjykatës tjerë, vendos për ankesat kundër vendimeve të këshillit për fëmijë të gjykatës themelore, si dhe në raste tjera të përcaktuara me këtë ligj.⁴⁷ Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë formohet këshill për fëmijë i përbërë prej pesë gjykatësve. Këshilli për fëmijë vendos për këshilla juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme të parapara në këtë ligj dhe e përcjell e punon në avancimin e praktikës gjyqësore në këtë sferë dhe përpilon analiza.⁴⁸

2.3. Prokurori publik për veprim me fëmijë

Prokurori publik është subjekt dhe palë në procedurën penale e cila në emër të shtetit jep iniciativë për fillim të ndjekjes penale të veprave penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare.⁴⁹ Sipas Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë në procedurë ndaj fëmijëve për veprime që me ligj janë të parapara si vepra penale, paditës i autorizuar mund të jetë vetëm prokurori publik.⁵⁰ Prokurori publik në procedurë ndaj fëmijëve është organ i specializuar me atë që

⁴⁶ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.93

⁴⁷ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013., n.102, p.6

⁴⁸ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.103

⁴⁹ Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f. 167

⁵⁰ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.89

specializim e arrinë përmes obligimit për trajnime në kohëzgjatje prej së paku pesë ditë gjatë vitit në vend dhe jashtë vendit.⁵¹

2.4. Mbrojtësi

Në bazë të Kushtetutës së R.M.-së, sicili person ka të drejtë në mbrojtës në procedurën parapenale dhe atë gjyqësore.⁵² Mbrojtës në procedurë penale mund të paraqitet vetëm avokati.⁵³ Fëmiu mund të merret në pyetje vetëm në prezencë të mbrojtësit të tij.⁵⁴

Mbrojtja e fëmiut në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore është obligatore.⁵⁵ Për dallim nga procedura ndaj personave madhorë, ku në raste të mbrojtjes fakultative, i pandehuri ka të drejtë që në mënyrë të pamvarur të vendosë nëse do të angazhojë mbrojtës ose jo, ndërsa në procedurën ndaj fëmijve, pa marrë parasyshë veprën e cila është kryer, fëmua patjetër të ketë mbrojtës në secilën fazë të procedurës penale.⁵⁶ Mbrojtësin nga radhët e avokatëve e emëron gjykata me detyrë zyrtare, nëse vet fëmija ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk siguron mbrojtës, e në rastet kur fëmija dhe prindi/ët, ose tutori/ët e tij, nuk janë në gjendje që t'i paguajnë shpenzimet për avokatin, shpenzimet janë në llogari të buxhetit gjyqësor.⁵⁷ Që të mundet avokati të paraqitet si mbrojtës në procedurë ndaj fëmiut ai është i obliguar që së paku pesë ditë gjatë vitit të ndjekë trajnime të specializuara nga drejtësia për fëmijë në vend ose jashtë shtetit.⁵⁸

⁵¹ Buzharovska, G.L., Nanëv, L., Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, fq.167

⁵² Kushtetuta e R.M. n. 12

⁵³ LPP, n. 71, p.4

⁵⁴ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.92

⁵⁵ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.90

⁵⁶ Buzharovska, G.L., Nanëv, L., Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f. 170.

⁵⁷ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.90, p.2

⁵⁸ Buzharovska, G.L., Nanëv, L., Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f.170

2.5. Qendra për punë sociale

Sipas Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë **organe tjera të specializuara** janë qendrat për punë sociale, prokuroria publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet për zbatimin e sanksioneve për fëmijë⁵⁹. Ligji mbi drejtësinë për fëmijë iu jep një rol të veçantë këtyre organeve të specializuara, posaçërisht Qendrave për punës sociale në parandalimin e delikuençës së fëmijëve, si dhe në procedurën për realizim të masave të ndihmës dhe mbrojtjes të cilat luajnë një rol të madh në resocializimin e vetë fëmijut, paraprakisht pa mos e dënuar në mënyrë represive⁶⁰. Masën e paraburgimit gjykatësi për fëmijë mund ta caktojë vetëm me propozim të prokurorit publik, pas mendimit të marrë paraprakisht nga qendra.⁶¹ Në procedurë ndaj fëmijëve qendra ka të drejtë të njoftohet me rrjedhën e procedurës, gjatë procedurës të japë propozime dhe t'i potencojë faktet që kanë të bëjnë me personalitetin dhe rrethanat ku jeton dhe zhvillohet fëmija, e që janë me rëndësi për miratimin e vendimit të drejtë.⁶²

⁵⁹ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n..19, p.12

⁶⁰ Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f. 172

⁶¹ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.117, p.1

⁶² Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.97, p.1

Kapitulli III

3. MASAT PËR SIGURIM TË PREZENCËS SË FËMIJËS DHE ZHVILLIMI I PROCEDURËS PENALE NDAJ FËMIJËVE

Procedura penale zhvillohet me pjesëmarrjen e shumë subjekteve procedural. Për sigurimin e pranisë së tyre, Ligji i procedurës penale parasheh mundësinë e zbatimit të disa masave. Masat e tilla janë të natyrës së ndryshme dhe pikësëpari kanë të bëjnë me thirrjen e subjektit procedural, mirëpo ndaj disa subjekteve mund të ndërmerren edhe masa të tjera deri tek kufizimi i lirisë (ndaj të pandehurit).⁶³ Ligji i procedurës penale parasheh një sere masash të tilla të cilat mund të shqiptohen ndaj të pandehurit të moshës madhore, të tilla masa janë: Thirrja, masat parandaluese, dorëzania (garancia), shoqërimi (sjellja me force), arresi, mbajtja, paraburgimi afatshkurtës, arresti shtëpiak dhe paraburgimi.

Ndërkaq, në bazë të Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë privimi i fëmijës nga liria zbatohet vetëm si mjet i fundit në procedurë, dhe vetëm në kushte dhe në kohëzgjatje të përcaktuar me ligj.⁶⁴ Në procedurë ndaj fëmijut nga masat për sigurim të presences së të pandehurit dhe për zhvillillim pa pengesa të procedurës penale mund të zbatohen: **Thirrja, dorëzania (garancioni), shoqërimi, mbajtja, paraburgimi afatshurtër dhe paraburgimi.**⁶⁵

3.1. Thirrja:

Thirrja e fëmijës për të cilin ekzistojnë baza për dyshim se ka kryer veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale, për shkak të mbledhjes së informatave nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme kryhet sipas dispozitave të Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.⁶⁶ Procedura ndaj fëmijut karakterizohet edhe me veçanti që kanë të bëjnë me thirrjen e fëmijut si masë më e butë për sigurimin e presences së subjekteve në

⁶³ Sahiti E., Zejnli I. E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, UEJL, Fakulteti i Drejtësisë, Shkup, 2017, f. 131

⁶⁴ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.10

⁶⁵ Buzharovska, G.L., Nanev, L., Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f. 176

⁶⁶ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n116, p.1

procedure penale. Thirrja është akt i shkruar i drejtuar nga ana e gjyqit me të cilin të pandehurit ose personit tjetër i kërkohet të vijë në orarin e caktuar, në vendin e caktuar, me paralajmërim se në rast të mosardhjes do të jetë i shoqëruar forcërisht.⁶⁷ Duke marrë parasyshë moshën e fëmijut, ligjvënësi ka përcaktuar që fëmiju të thirret perms prindërve/tutorëve përveç nëse kjo nuk është e mundur për shkak të nevojës për veprim urgjent ose rrethanave të tjera.⁶⁸

Para fillimit të bisedës, fëmija njoftohet edhe me të drejtat dhe detyrat e tij të veçanta të parapara me dispozitat e Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë. Biseda me fëmijën, detyrimisht mbahet në praninë e mbrojtësit të tij dhe prindit/ëve, ose përfaqësuesit ligjor. Para bisedës personi zyrtar është i obliguar që ta njoftojë fëmijën me arsyet për thirrjen dhe me të gjitha faktet që kanë të bëjnë me rastin që është lëndë e bisedës. Biseda me fëmijën mbahet në hapësira të veçanta adekuate për bisedë me fëmijë të asaj moshe dhe mund të zgjasë, nëse fëmija pranon të bisedojë më së shumti katër orë. Sipas nevojës biseda mundet në pajtim me fëmijën, të vazhdojë edhe ndonjë ditë tjetër, ose ditë tjera.⁶⁹

3.2. **Mbajtja** e fëmijës në stacion policor mund të zgjasë më së shumti deri në 12 orë. Persona të autorizuar zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme mund të mbajnë më së shumti deri në tetë orë, fëmijën e zënë në kryerjen e veprimit që me ligj është paraparë si kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike, nëse vendosja e rendit dhe qetësisë publike ose evitimi i rrezikimit nuk mund të arrihet në mënyrë tjetër ose kur është nën ndikimin e alkoolit, drogës ose substancave tjera psikotropike. Fëmijën që e ka dorëzuar organi i huaj i sigurisë për dërgim te organi kompetent shtetëror mund të mbahet më së shumti 12 orë. Për mbajtjen e fëmijës, me kushtet e parapara me ligj, personat zyrtarë të autorizuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme janë të obliguar që menjëherë ta njoftojnë prokurorin publik kompetent, gjykatësin për fëmijë ose gjykatësin e procedurës paraprake, prindin/ët e ose tutorin/ët, mbrojtësin e tij dhe qendrën. Njoftimi në raste urgjente bëhet nëpërmjet telefonit, e

⁶⁷ Buzharovska, G.L., Nanev, L., Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, fq. 176

⁶⁸ Ibid.

⁶⁹ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.116, p.2-5

për të njëjtin dorëzohet edhe njoftim me shkrim në afat prej 24 orësh. Gjatë mbajtjes nuk mund të mbahet bisedë pa praninë e mbrojtësit.⁷⁰

Nëse fëmija ose prindi/ët, ose tutori/ët e tij nuk marrin mbrojtës, personat zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme do të caktojnë mbrojtës nga lista e avokatëve e dorëzuar nga Oda e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë. Shpenzimet për mbrojtësin i bartin prindi/ët, ose tutori/ët e fëmijës. Shpenzimet e avokatit janë të llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë në pajtim dhe me kushte të parapara me Ligjin për ndihmë falas juridike, vetëm në rast kur prindi/ët, ose tutori/ët nuk janë në gjendje t'i paguajnë shpenzimet.⁷¹

Personat e autorizuar zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme e mbajnë fëmijën në lokale adekuate për mbajtjen e fëmijës së moshës së tij, të ndryshme nga lokalet për mbajtjen e personave të moshës madhore. Për mbajtjen përpilohet procesverbal në të cilin shënohen të gjitha të dhënat, për ditën dhe orën kur fëmija është mbajtur, shkaqet e mbajtjes, koha kur është këshilluar për të drejtat e tij, gjendjen psikofizike në momentin e mbajtjes së tij, koha kur është biseduar me të, konstatimi i personave zyrtarë për ekzistimin e lëndimeve të dukshme trupore dhe koha e ndërprerjes së mbajtjes. Procesverbalin e nënshkruajnë fëmija dhe prindi/ët, ose tutori/ët e tij, si dhe mbrojtësi. Mbajtjen më gjatë se gjashtë orë domosdo duhet ta miratojë nëpunësi për pranim në stacion të përcaktuar e të pajisur të veçantë policor. Fëmija i mbajtur doemos duhet që pa prolongim, e më së voni në afat prej 12 orësh të nxirret para gjykatësit për fëmijë, që do të vendosë për përcaktimin e paraburgimit ose për lëshimin në liri të fëmijës.⁷²

(17) Nëse gjykatësi për fëmijë konstaton se nuk ka bazë për mbajtjen e fëmijës do të marrë aktvendim për lëshimin në liri të tij, në të cilin do ta vlerësojë edhe ligjshmërinë e mbajtjes së tij.

⁷⁰ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.116, p.5-10

⁷¹ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.116, p.11,12

⁷² Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.116, p.13-18

(18) Fëmija dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë ankese te këshilli penal për fëmijë të gjykatës themelore në pjesën e aktvendimit ku vlerësohet ligjshmëria e privimit nga liria.⁷³

3.3. Paraburgimi afatshkurtër

Nëse prokurori publik në afatin e paraparë në nenin 116 paragrafi (15) i këtij ligji nuk paraqet kurrfarë propozimi (në rast të mbajtjes së fëmiut në stacion policor më gjatë se gjashtë orë) gjykatësi për fëmijë mund të marrë vendim për përcaktimin e paraburgimit afatshkurtër, nëse janë plotësuar kushtet ligjore për përcaktimin e paraburgimit. Paraburgimi afatshkurtër mund të zgjasë më së shumti 24 orë. Nëse në këtë afat prokurori publik nuk parashtroi propozim për caktimin e paraburgimit, gjykatësi për fëmijë do të marrë aktvendim për lëshimin në liri të fëmijës. Kundër aktvendimit për paraburgim afatshkurtër, fëmija, mbrojtësi i tij dhe prokurori publik kanë të drejtë ankese te këshilli penal për fëmijë të gjykatës themelore, i cili pas ankesës vendos në afat prej 24 orësh.⁷⁴

3.4. Paraburgimi

Me Ligjin e procedurës penale të vendit tone, janë präcaktuar kushtet në të cilat mund të paraburgoset një person duke e autorizuar gjykatën që të caktëjë paraburgimin po që se vlerëson se është plotësuar ndonjëri prej kushteve ligjore. Me këtë rast, është me rëndësi të theksohet se për caktimin e paraburgimit pikësëpari duhet të plotësohet një kusht themelor e ai është **dyshimi i bazuar** se person ii dyshuar ka kryer vepër penale. Pastaj vijnë në konsiderim ndonjëri prej shkaqeve tjera që i parasheh neni 165 i Ligjit të procedurës penale. Sipas tij paraburgimi caktohet kundër personit konkret kur:

- a. Ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer vepër penale,
- b. Ekziston ndonjëri nga shkaqet në vijim:

⁷³ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.116

⁷⁴ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.117, p.4,5

1. Kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i arratisjes.
2. Kur dyshohet se do të fshihet dhe do ti falsifikojë, asgjësojë gjurmët e veprës penale, ose kur rrethana të posaçme sugjerojnë se do të pengojë procedurën penale duke ndikuar në dëshmitarë, ekspertë, bashkëpjesmarrës etj.
3. Kur rrethana të veçanta e arsyetojnë frikën se ai do të përsërisë veprën penale, ose do të përfundojnë veprën e tentuar ose do të kryejë veprën penale për të cilën është kanosur.
4. Nëse i pandehuri i thirrur në mënyrë të rregullt qartazi i shmanget ardhjes në shqyrtim gjyqësor, ose nëse gjykata ka bërë dy tentime në mënyrë të rregullt ta thërrasë të pandehurin, ndërsa rrethanat sugjerojnë se ai në mënyrë evidente i shmanget thirrjes.⁷⁵

Masën e paraburgimit gjykatësi për fëmijë mund ta caktojë vetëm me propozim të prokurorit publik, pas mendimit të marrë paraprakisht nga qendra. Fëmijës mund t'i caktohet masë e paraburgimit kur ekziston bazë e paraparë me Ligjin për procedurë penale. Paraburgimi mund të shqiptohet vetëm si masë e fundit nëse nuk janë plotësuar kushtet për zbatimin e masave tjera të sigurimit të pranisë së fëmijës të parapara në Ligjin për procedurë penale. Gjykatësi për fëmijë në veçanti do ta vlerësojë dhe obligohet ta arsyetojë zbatimin e masës së paraburgimit, duke u nisur nga personaliteti i fëmijës, pasojat e mundshme të paraburgimit ndaj personalitetit të tij dhe zhvillimit të tij të drejtë.

Në vend të paraburgimit, gjykatësi për fëmijë i zbaton sipas rregullës masat e parapara në nenin 115 të Ligjit për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë me ç'rast fëmija gjatë procedurës përgatitore përkohësisht të vendoset në institucion për arsim, kujdes dhe mbrojtje të fëmijëve, vendosjen nën mbikëqyrje të qendrës ose të vendosët në familje përkujdesëse ose tjetër, nëse kjo është e nevojshme për dhënien e ndihmës, mbrojtjes ose kujdesit të fëmijës, kur janë të plotësuar kushtet ligjore për zbatimin e tyre, përveç kur ekziston rrezik që fëmija

⁷⁵ Sahiti E., Zejneli I. E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, UEJL, Fakulteti i Drejtësisë, Shkup, 2017, f. 140-141 (Ligji i procedurës penale i R.M.V.-së, (2013), n.165)

përsëri të kryejë veprim që me ligj është e paraparë si vepër penale ose kur kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të fëmijës.⁷⁶

Paraburgimi përcaktohet me aktvendim të gjykatësit për fëmijë dhe mund zgjasë më së shumti deri në 30 ditë. Me propozim të arsyetuar të gjykatësit për fëmijë e pas mendimit të marrë paraprakisht nga prokurori publik dhe të qendrës, këshilli për fëmijët i gjykatës themelore mundet për shkaqe të arsyeshme ta zgjasë paraburgimin edhe për 60 ditë. Nëse paraburgimi është caktuar vetëm për përcaktimin e identitetit të fëmijës, gjykatësi për fëmijë, ose këshilli për fëmijë obligohet të miratojë aktvendim për heqjen e tij menjëherë pasi të përcaktohet identiteti. Gjykatësi për fëmijë është i detyruar që menjëherë pas përcaktimit të paraburgimit për këtë t' njoftojë prindin/ët ose tutorin/ët e fëmijës, mbrojtësin e tij dhe qendrën.⁷⁷

Në paraburgim fëmija vendoset ndaras nga personat e moshës madhore. Fëmijës i sigurohet në paraburgim e drejta për punë dhe aktivitet tjetër që është e dobishme për edukimin e tij dhe evitimin e pasojave negative nga privimi nga liria ndaj personalitetit të tij. Gjatë kohëzgjatjes së paraburgimit, fëmijës i garantohet dhe sigurohet e drejta e kontaktimit me familjen të paktën një herë në javë, e drejta e kontaktimit privat dhe të fshehtë sipas nevojës, e drejta për kujdes dhe mbrojtje mjekësore, e drejta e përcjelljes së informatave përmes mjeteve për informim publik. Gjykatësi për fëmijë ndaj fëmijëve të paraburgosur i ka të njëjtat autorizime që sipas Ligjit për procedurë penale i takojnë gjykatësit të procedurës paraprake në lidhje me të paraburgosurit dhe obligohet së paku një herë gjatë një paraburgimi afatshkurtër ta vizitojë fëmijën e paraburgosur, e nëse paraburgimi zgjat më shumë ta vizitojë të paktën një herë në çdo dhjetë ditë.⁷⁸

⁷⁶ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.117, p.1-3

⁷⁷ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.118, p.1-4

⁷⁸ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.120

3.5. Inicimi i procedurës

Procedura ndaj fëmijës mbi 14 vjet për veprim që me ligj është paraparë si vepër penale ngritet vetëm me kërkesë të prokurorit publik.⁷⁹ Në këtë rast vinë në shprehje zbatimi i parimit të oficialitetit.

Për veprime që me ligj janë të parapara si vepra penale për të cilat ndiqet me propozim ose padi private, procedura mund të ngritet nëse i dëmtuari në afat prej tre muajsh nga zbulimi i veprës së kryer ose kryerësit, ka dhënë propozim për ngritjen e procedurës te prokurori publik kompetent. Nëse prokurori publik nuk dorëzon kërkesë për ngritjen e procedurës ndaj fëmijës, do ta njoftojë për këtë të dëmtuarin. I dëmtuari nuk mund ta ndërmarrë procedurën, ose nuk mund të parashtrojë padi private në gjykatë, por mundet në afat prej tetë ditësh nga pranimi i njoftimit të kërkojë që këshilli për fëmijë i gjykatës kompetente të vendosë për ngritjen e procedurës.⁸⁰

Para se të vendos nëse do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës përgatitore, prokurori publik e dëgjon fëmijën në prani të prindit/ëve, ose tutorit/ëve të tij dhe mbrojtësit, përveç kur gjendja e tij psikofizike këtë nuk e lejon. Nëse fëmija dhe prindi/ët, ose tutori/ët e tij nuk marrin mbrojtës, prokurori publik me detyrë zyrtare nga lista avokatëve të dorëzuar nga Oda e avokatëve do t'i caktojë mbrojtës.⁸¹

Kur janë të plotësuar kushtet për dënim të fëmijës në rrezik mbi 14 vjeç nga dispozitat e neneve 50 deri në 56 të Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë, sipas të cilave: Mund të dënohet fëmija mbi moshën 16 vjet me përgjegjësi penale, vetëm nëse për shkak të pasojave të rënda nga vepra e kryer dhe shkalla e lartë e përgjegjësisë penale nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohet masë edukuese. Fëmijës mbi moshën 16 vjet mund t'i shqiptohen dënimet në vijim:

- burg për fëmijë,
- dënim me para,

⁷⁹ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.106, p.1

⁸⁰ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.106

⁸¹ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.107, p.1,2

- ndalim i drejtimit të automjetit motorik të llojit ose kategorisë së caktuar dhe
- dëbim i të huajit nga vendi.⁸²

Në këtë rast prokurori publik mundet që para se të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurë përgatitore, t'i propozojë fëmijës, mbrojtësit të tij, prindit/ëve, ose tutorit/ëve që të ngritet procedurë e veçantë për pranimin e përgjegjësisë dhe marrëveshje për shumën e dënimit. Propozim të këtillë prokurori publik mund të parashtrojë në rastet kur disponon me argumente të cilat padyshim tregojnë se fëmija është kryerësi i veprës penale, se është përgjegjës për veprën e kryer dhe se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e dënimit. Në procedurën për marrëveshje prokurori publik do t'i mbledhë të gjitha raportet e nevojshme dhe dokumentet tjera për personalitetin e fëmijës dhe do të sigurojë pëlqim nga i dëmtuari.

Nëse me propozimin pajtohet edhe i dëmtuari, prokurori publik i thirr në marrëveshje publike fëmijën, përfaqësuesin e tij ligjor, mbrojtësin, qendrën dhe të dëmtuarin. Nëse në marrëveshje arrihet pëlqim, përpilohet marrëveshje që e nënshkruajnë të gjithë pjesëmarrësit e pranishëm.

Prokurori publik e dorëzon marrëveshjen te këshilli për fëmijë që mund ta pranojë marrëveshjen dhe të miratojë aktgjykim me të cilin do ta shqiptojë sanksionin e propozuar, kundër të cilit nuk lejohet ankesë. Nëse gjykata nuk e pranon marrëveshjen, e kthen lëndën te prokurori publik i cili është i obliguar që të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës përgatitore.

Gjatë procedurës përgatitore, shkresat gjyqësore dhe deklaratat e fëmijës dhe mbrojtësit të tij të dhëna në procedurën për marrëveshje nuk guxojnë të përdoren si argumente dhe do të veçohen nga procedura gjyqësore.⁸³

3.6. Procedura përgaditore ndaj fëmiut

Prokurori publik parashtroi kërkesë për ngritjen e procedurës përgatitore te gjykatësi për fëmijë në gjykatën kompetente. Nëse gjykatësi për fëmijë nuk pajtohet me kërkesën e

⁸² Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.50

⁸³ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.108, p.1-5

prokurorit publik, do të kërkojë që për këtë të vendosë këshilli penal për fëmijë i gjykatës themelore. Gjykatësi për fëmijë mundet organet e punëve të brendshme t'i urdhërojë të kryejnë bastisje të shtëpisë ose për marrjen e përkohshme të sendit ose veprime tjera në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë penale.⁸⁴

Nëse gjykatësi për fëmijë pas marrjes në pyetje të fëmijës dhe marrjes së raportit për fëmijën dhe rrethanat e veprës nga qendra, vlerëson se nuk ka nevojë për zbatimin e veprimeve tjera të procedurës përgatitore, do ta parashtrojë lëndën para këshillit për fëmijë për zgjidhje përfundimtare në afat jo më të gjatë se tetë ditë. Qendra e dorëzon raportin në afat prej një muaji.⁸⁵

Këshilli për fëmijë vendos në seancë pasi që paraprakisht do t'i mbledhë shkresat nga prokurori publik. Në seancë thirret edhe prokurori publik. Këshilli për fëmijë mund të vendosë që të mos mbahet procedurë përgatitore ose ndaj fëmijës të ngrihet procedurë para gjykatësit për fëmijë. Kundër vendimit të këshillit për fëmijë nuk lejohet ankesë. Kur këshilli do të vendosë që ndaj fëmijës të ngrihet procedurë para gjykatës për fëmijë, prokurori publik mund që të marrë pjesë në këtë procedurë dhe i ka tërë autorizimet që sipas këtij ligji i takojnë në procedurë.⁸⁶

Në procedurë përgatitore ndaj fëmijës krahas fakteve që kanë të bëjnë me veprimet që me ligj janë të parapara si vepra penale, në veçanti do të përcaktohen mosha e fëmijës, rrethanat e nevojshme për vlerësimin e zhvillimit të tij shpirtëror, do të hulumtohen mjedisi dhe rrethanat në të cilat ka jetuar fëmija dhe rrethanat tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e tij.⁸⁷

Për përcaktimin e rrethanave të lartpërmendura do të dëgjohen prindi/ët e fëmijës, ose tutori/ët e fëmijës dhe persona tjerë që mund t'i japin të dhënat e nevojshme. Për këto rrethana do të kërkohet raport nga Qendra për punë sociale, e nëse ndaj fëmijës është zbatuar sanksion për veprim të kryer më herët që me ligj është e paraparë si vepër penale, do të merret

⁸⁴ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.109

⁸⁵ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.110, p.1

⁸⁶ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.112

⁸⁷ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.113

raport për zbatimin e atij sanksioni. Të dhënat për personalitetin e fëmijës i mbledh gjykatësi për fëmijë, përmes qendrës në afat prej 30 ditësh. Kur për përcaktimin e gjendjes shëndetësore të fëmijës, të zhvillimit të tij shpirtëror, për veçoritë e tija psikike, aftësitë ose prirjet, është e nevojshme që fëmijën ta kontrollojë ekipi profesional, për këtë kontroll do të caktohen mjeku, psikologu dhe pedagogu që kontrollojnë mund ta kryejnë edhe në institucione të specializuara shëndetësore. Kontrolli nga ekipi profesional kryhet në afat prej 30 ditësh.⁸⁸

Në veprimet në procedurë përgatitore mund të marrë pjesë edhe prokurori publik. Pyetja e fëmijës, me vlerësim të gjykatësit do të kryhet me ndihmën e pedagogut, psikologut ose personit tjetër profesional. Gjykatësi për fëmijë mund të lejojë që gjatë veprimeve në procedurë përgatitore të marrë pjesë edhe përfaqësuesi nga qendra dhe prindi/ët, ose tutori/ët e fëmijës. Kur personat e theksuar marrin pjesë në këto veprime, mund të japin propozime dhe t'i parashtrojnë pyetje personit që merret në pyetje ose dëgjohet.⁸⁹

- **Ndërprerja e procedures në fazën e procedurës përgatitore**

Ekzistojnë raste kur gjykatësi për fëmijë gjatë rrjedhës së procedures përgatitore do të vërtetojë se ekzistojnë shkaqe për ndërprerje të procedurës dhe në atë rast kur do të konstatohet se:

- Vepra e cila i ngarkohet fëmiut nuk është vepër penale e përcaktuar me ligj;
- Ka ndodhur parashkrim i veprës ose vepra është përfshirë me akt të amnesties ose faljes;
- Ekzistojnë rrethana tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale;
- Nuk ka prova se fëmiu e ka kryer veprën penale.⁹⁰

- **Përfundimi i procedurës përgatitore**

Për përfundim të procedurës përgatitore ndaj fëmiut gjykatësi për fëmijë nuk sjellë një vendim formal. Kur gjykatësi për fëmijë si dominus litis në procedurën përgatitore ndaj

⁸⁸ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.113

⁸⁹ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.114, p.2-4

⁹⁰ Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, fq. 189

fëmijës, do të vlerësojë se qëllimi i këtij stadi është arritur, i parashtrohet shkresat tek prokurori publik. Pas pranimit të shkresave penale nga gjykatësi për fëmijë, prokurori publik mundet që në afat prej 8 ditësh të ndërmerr një nga veprimet në vijim:

- Të kërkojë që procedura përgaditore të plotësohet; të jepë deklaratë për tërheqje nga ndjekja e mëtutjeshme, me ç'rast gjykatësi për fëmijë është i obliguar të sjellë vendim për ndërprerje të procedurës; Të sjellë propozim të arsyetur deri tek Këshilli për fëmijë për zbatim të sanksionit.⁹¹

3.7. Procedura para Këshillit për fëmijë

Pas pranimit të propozimit të prokurorit publik, kur dhe si procedura ndaj fëmijës udhëhiqet pa propozim të prokurorit publik, gjykatësi për fëmijë i cili kryeson me këshillin për fëmijët cakton mbledhje të këshillit, nëse është përcaktuar gjendja faktike e pakontestueshme. Në mbledhjen e këshillit mund të vendoset të mbahet shqyrtimi kryesor nëse nevojitet përcaktimi i gjendjes faktike. Dënimet dhe masat e entit mund të shqiptohet vetëm pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor. Sanksione tjera mund të shqiptohen edhe në mbledhje të këshillit. Për mbledhjen e këshillit njoftohen dhe në të mund të marrin pjesë prokurori publik, mbrojtësi dhe përfaqësuesi i qendrës, sipas nevojës edhe fëmija me prindin/ët, ose tutorin/ët e tij. Gjykatësi për fëmijë do t'ia shqiptojë fëmijës sanksionin që ndaj tij është shqiptuar në mbledhjen e këshillit.⁹²

Kur këshilli për fëmijë vendos në shqyrtimin kryesor, në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën penale për përgatitjet për shqyrtimin kryesor, për udhëheqjen me shqyrtimin kryesor, për shtyrjen ose ndërprerjen e shqyrtimit kryesor, për procesverbalin dhe rrjedhën e shqyrtimit kryesor, por këshilli mund të shmanget nga këto rregulla nëse konsideron se zbatimi i tyre në këtë rast nuk do të jetë i përshtatshëm. Në shqyrtimin kryesor do të ftohen prokurori publik, i dëmtuari, fëmija dhe mbrojtësi i tij, prindi/ët, ose tutori/ët dhe

⁹¹ Buzharovska, G.L., Nanev, L., Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, fq. 190

⁹² Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.125

përfaqësuesi i qendrës, ose anëtari i ekipit profesional që i ka përgatitur konstatimet dhe mendimin. Mosardhja e prindit/ëve, ose tutorit/ëve ose përfaqësuesit të qendrës nuk e pengon gjykatën që të mbajë shqyrtimin kryesor. Në rast të mungesës së prindit/ëve, ose tutorit/ëve, gjykata do ta ngarkojë mbrojtësin që t'i përfaqësojë edhe interesat e tyre.⁹³

Gjatë procedurës, këshilli për fëmijë mund të miratojë vendim për vendosje të përkohshme të fëmijës, ta anulojë vendimin e këtyllë të miratuar më herët ose të përcaktojë paraburgim.⁹⁴

Gjykatësi për fëmijë i cili kryeson me këshillin për fëmijë është i detyruar të caktojë shqyrtim kryesor ose mbledhje të këshill në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së propozimit nga prokurori publik ose nga dita e mbarimit të procedurës përgatitore ose nga dita kur në mbledhjen e këshillit vendoset që të mbahet shqyrtimi kryesor. Për çdo zgjatje të kësaj periudhe gjykatësi për fëmijë duhet të ketë leje nga kryetari i gjykatës.⁹⁵

3.8. Vendimet e Këshillit për fëmijë

Këshilli për fëmijët nuk është i lidhur me propozimin e prokurorit publik gjatë vendosjes nëse ndaj fëmijës do të shqiptojë dënim ose do të zbatojë sanksion tjetër.

Këshilli me **aktvendim** do ta ndërpresë procedurën në rastet kur sipas dispozitave të Ligjit për procedurë penale miraton aktgjykim me të cilin refuzohet aktakuza ose me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza, si dhe kur këshilli do të konstatojë se nuk është e përshtatshme që fëmijës t'i shqiptohet sanksion.

Masa edukuese dhe masa të sigurisë këshilli shqipton me **aktvendim**, në shqiptimin e të cilit theksohet vetëm çfarë mase është shqiptuar, por fëmija nuk do të shpallet fajtor për veprën që

⁹³ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.126

⁹⁴ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.127

⁹⁵ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.128

me ligj është paraparë si vepër penale që i ngarkohet. Në arsyetim të aktvendimit do të theksohet përshkrimi i veprës dhe rrethanat që e arsyetojnë zbatimin e masës së theksuar.

Aktgjykimi me të cilën fëmijës i shqiptohet dënim ose masë alternative miratohet në formën e aktgjykimit gjykues të paraparë me Ligjin për procedurë penale.⁹⁶ Nga analiza e bazave mbi të cilat këshilli për fëmijë mund ta ndërpresë procedurën, del se këshilli për fëmijë mund të sjellë vetëm një lloj të aktgjykimit - dënues respektivisht aktgjykim kondemnator, në pajtim me dispozitën 404 të Ligjit të procedurës penale. Më aktgjykimin shqiptohet dënimi me burg ose masë alternative (Dënim me kusht me mbikqyrje të shtuar ose punë në dobi të përgjithshme).⁹⁷ Gjykata mundet fëmijën ta dënojë me pagesë të shpenzimeve të procedurës dhe në plotësimin e kërkesave pronësore-juridike në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurë penale, vetëm nëse fëmijës i është shqiptuar dënim ose masë alternative. Nëse ndaj fëmijës është zbatuar masë edukuese, shpenzimet e procedurës janë në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, përveç nëse fëmijës i shqiptohet detyrim i veçantë për kompensim të dëmit.⁹⁸ Gjykatësi për fëmijët është i detyruar që me shkrim ta përgatisë vendimin në afat sa më shkurtër të mundshëm, që nuk është më shumë se 15 ditë, e në rastet më të ndërlikuara 30 ditë nga dita e shpalljes së tij.⁹⁹

3.9. Mjetet juridike

Mjetet juridike janë veprime procedurale, me të cilat palët dhe personat e tjerë të autorizuar në procedurë, e atakojnë vendimin të cilin e konsiderojnë jo të drejtë dhe jo të ligjshëm dhe kërkojnë që gjykata e mjetit juridik, pasi të vërtetojë bazueshmërinë e thënieve të tyre, ta

⁹⁶ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.129

⁹⁷ Buzharovska, G.L., Naney, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f. 194

⁹⁸ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.130

⁹⁹ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, 131

ndryshojë ose ta prishë atë me vendim të vetin.¹⁰⁰ Mjetet juridike në kuptimin e ngushtë mund të ndahen në mjete të rregullta juridike dhe në mjete jo të rregullta juridike. Kufiri ndarës midis tyre është forma e prerë e vendimit gjyqësor. Mjeti i rregullt juridik ushtrohet kundër vendimit i cili ende nuk e ka marrë formën e prerë, derisa gjykata e shkallës së dytë (në disa raste edhe gjykata e shkallës së tretë) të merr vendim lidhur me të.¹⁰¹ Ndërsa mjetet e jashtëzakonshme juridike përdoren kundër vendimeve të cilat kanë fituar formën e prerë.¹⁰²

3.9.1. Ankesa si mjet i rregullt juridik

Sipas dispozitave të Ligjit për drejtësinë për fëmijë kundër aktvendimit, ose aktgjykimit me të cilin fëmijës i është shqiptuar sanksion, si dhe kundër aktvendimit për ndalimin e procedurës mund të deklarojnë ankesë të gjithë personat që kanë të drejtë ankese kundër aktgjykimit sipas dispozitave të Ligjit për procedurë penale, e në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit ose aktgjykimit. I dëmtuari mund të paraqesë ankesë vetëm lidhur me kërkesën pronësore juridike.

Mbrojtësi, prokurori publik, bashkëshorti, ose shoku jashtëmartesor, farefisi sipas gjakut në vijë të drejtë, tutori, vëllai dhe motra mund të paraqesin ankesë në emër të fëmijës edhe kundër vullnetit të tij.

Ankesa kundër aktvendimit me të cilin shqiptohet masë edukuese e cila mbahet në institucion e ndalon zbatimin e aktvendimit, nëse gjykata në pajtim me prindin/ët, ose tutorin/ët e fëmijës edhe pas dëgjimit të fëmijës nuk vendos ndryshe.

Për mbledhjen e këshillit për fëmijë në gjykatën e apelit do të njoftohen fëmija dhe mbrojtësi i tij nëse ata këtë e kërkojnë.¹⁰³

Këshilli për fëmijë i gjykatës së apelit mund ta ndryshojë vendimin e shkallës së parë me shqiptim të sanksionit më të rëndë ndaj fëmijës, vetëm më bazë të ankesës së paraqitur nga

¹⁰⁰ Sahiti E., Zejneli I. E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, UEJL, Fakulteti i Drejtësisë, Shkup, 2017, f. 273

¹⁰¹ Sahiti E., Zejneli I. E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, UEJL, Fakulteti i Drejtësisë, Shkup, 2017, f. 274

¹⁰² Ibid.

¹⁰³ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.132

ana e prokurorit publik. Nëse me vendimin e shkallës së parë nuk është shqiptuar dënim ose masë e entit, këshilli mundet këtë dënim ose masë, ta shqiptojë vetëm nëse mban shqyrtim. Burgu për fëmijë në kohë më të gjatë ose masë më e rëndë e entit nga ajo që është shqiptuar nga vendimi i shkallës së parë mund të shqiptohet dhe në mbledhjen e këshillit.¹⁰⁴

3.9.2. Mjetet e jashtëzakonshme juridike

Në procedurën ndaj fëmijës zbatohet mjete të jashtëzakonshme juridike të parapara me dispozitat e Ligjit të procedurës penale. MUND të parashtrohen këto mjete të jashtëzakonshme juridike:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë;

Përsëritje e procedurës penale e përfunduar me aktgjykim të p,otëfuqishëm;

Përsëritje e procedurës penale e përfunduar me vendim për zbatim të masës edukuese;

Përsëritje e procedurës penalee përfunduar me vendim për ndërprerje të procedurës ndaj fëmijës.¹⁰⁵

Kundër vendimit të gjykatës së apelit për ndryshim të vendimit të shkallës së parë me shqyrtim të mbajtur me të cilin shqiptohet dënim ose masë e entit në vend të masës edukuese, mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Supreme në afat prej tetë ditësh nga dita e miratimit të vendimit.¹⁰⁶

¹⁰⁴ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.133

¹⁰⁵ Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015, f. 197

¹⁰⁶ Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013, n.134

Kapitulli IV

4. NUMRI I FËMIJËVE TË GJYKUAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT: 2012-2017 DHE STUDIM I RASTEVE INDIVIDUALE NGA KRIMINALITETI I FËMIJËVE

4.1. Numri i fëmijëve të paraqitur: 2012-2017 në RMV

T-1 Numri i fëmijëve të paraqitur: 2012-2017 ¹⁰⁷						
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	1 001	1 005	972	772	587	578

Në tabelën nr. 1 janë pasqyruar të dhëna mbi numrin e fëmijëve të paraqitur për periudhën kohore 2012-2017 në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Të dhënat statistikore të paraqitura janë marrë nga publikimi i Entit shtetëror statistikor i vendit i emërtuar “Kryerës të veprave penale në 2017”, i publikuar në vitin 2018. Nga të dhënat rezulton tendenca e rrënies së numrit të fëmijëve të paraqitur për gjatë periudhës pesë vjeçare e cila është përcaktuar si periudhë hulumtimi.¹⁰⁸ Në vitin 2012 janë paraqitur penalisht gjithsej 1001 fëmijë, në vitin 2013 janë 1005, gjatë vitit 2014 janë 972 fëmijë, gjatë vitit 2015 gjithsej 772 fëmijë, gjatë vitit 2016 gjithsej 587 fëmijë dhe gjatë vitit 2017 gjithsej 578 fëmijë të paraqitur. Nga këto të dhëna shihet dukshëm zvogëlimi i numrit të fëmijëve të cilët janë paraqitur si kryerës të veprimeve të ciat me ligj parashihen si vepra penale.

¹⁰⁷ <http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=43>,

„Сторители на кривични дела во 2017”, („Perpetrators of criminal offences in 2017”), Статистички преглед: Население и социални статистики, Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, 2.4.18.07 (898) fq.106, Tabela: 24, Shkup, Qershor, 2018.

¹⁰⁸ Për vitin 2018 dhe 2019 ende nuk ka të dhëna të publikuara në webfaqe të Entit shtetëror statistikor, qasja e fundit Dhjetor 2019!

4.2. Numri i fëmijëve të akuzuar: 2012-2017 në RMV

T-2: Numri i fëmijëve të akuzuar: 2012¹⁰⁹						
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	778	657	712	465	702	554

Në tabelën nr. 2 janë paraqitur të dhëna për numrin e fëmijëve të akuzuar në vendin tonë, për periudhën kohore 2012-2017. Këto të dhëna janë marrë nga publikimi statistikor i Entit shtetëror statistikor të RMV-së.

Gjatë vitit 2012 janë akuzuar gjithsej 778 fëmijë, gjatë vitit 2013 gjithsej 657 fëmijë, gjatë vitit 2014 gjithsej 712 fëmijë, gjatë vitit 2015 gjithsej 465 fëmijë, gjatë vitit 2016 gjithsej 702 fëmijë dhe gjatë vitit 2017 rezultojnë gjithsej 554 fëmijë të akuzuar. Ndonëse numri i fëmijëve të akuzuar varion mes 400-700 brenda viteve, mund të konstatojmë se nga këto të dhëna mund të ekziston tendenca e rrënies së numrit të fëmijëve të akuzuar nga viti në vit, edhe pse jo me një diferencë shumë të theksuar, por që paraqet një tregues pozitiv për dinamikën e fenomenit të kriminalitetit të fëmijëve në vendin tonë. Këtu vinë në shprehje veçanërisht zbatimi i parimit të oportunitetit në procedurën penale ndaj fëmiut, që në këtë rast nënkupton autorizimin e prokurorit publik, si paditës i vetëm i autorizuar për veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare, për të vendosur nëse do të fillojë procedura e akuzimit, respektivisht nëse do të miratojë propozim akutë kundër fëmijut të paraqitur për kryerje të veprës penale.

¹⁰⁹ <http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=43>

„Сторители на кривични дела во 2017“, („Perpetrators of criminal offences in 2017“), Статистички преглед: Население и социални статистики, Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, 2.4.18.07 (898) fq.114, Tabela: 29, Shkup, Qershor, 2018.

4.3. Numri i fëmijëve të gjykuar: 2012-2017 në RMV

T-3: Numri i fëmijëve të gjykuar: 2012-2017 ¹¹⁰						
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	556	473	461	348	468	368

Në tabelën nr. 3 janë paraqitur të dhëna për numrin e fëmijëve të gjykuar në vendin tonë, për periudhën kohore 2012-2017. Këto të dhëna janë marrë nga publikimi statistikor i Entit shtetëror statistikor të RMV-së.

Për gjatë vitit 2012 janë gjykuar gjithsej 556 fëmijë, gjatë vitit 2013 gjithsej 473 fëmijë, gjatë vitit 2014 gjithsej 461 fëmijë, gjatë vitit 2015 gjithsej 348 fëmijë, gjatë vitit 2016 gjithsej 468 fëmijë dhe gjatë vitit 2017 rezultojnë gjithsej 368 fëmijë të gjykuar.

Nga këto të dhëna shihet se numri i fëmijëve të gjykuar nga viti në vit shkon në rrënie. Poashtu nëse krahasojmë numrin e fëmijëve të paraqitur dhe të atyre të akuzuar me numrin e fëmijëve të gjykuar, vërehet një numër shumë më i vogël i atyre të gjykuar në raport me dy të parët. Kjo sepse jo ç'do fëmijë i dyshuar për vepër penale, respektivisht kundër të cilit është ngritur kallëzim penal, do të akuzohet, apo do të ngritet akt akuzues ndaj tij, e poashtu jo për çdo rast për të cilin është parashtruar akt akuzues, me patjetër se do të mbarojë në aktvendim ose atkgjykim dënues.

¹¹⁰ <http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=43>

„Сторители на кривични дела во 2017„ („Perpetrators of criminal offences in 2017“), Статистички преглед: Население и социални статистики, Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, 2.4.18.07 (898) fq.115, Tabela: 30, Shkup, Qershor, 2018.

4.4. Studim i Vendimeve gjyqësore (Aktvendim/ aktgjykim) ndaj fëmiut të gjykuar për kryerje të veprës penale

Në vazhdim është analizuar praktika gjyqësore nga sfera e drejtësisë penale të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë. Duke pasur parasyshë parimet e drejtësisë për fëmijë si parimi i mbrojtjes së interesit të fëmiut dhe përjashtimi i publicitetit në procedurë penale ndaj fëmiut- grumbullimi i materialit për këtë pjesë të hulumtimit, respektivisht arritja deri në qasje të Vendimeve dhe Aktgjykimeve gjyqësore të shqiptuara ndaj fëmijëve nuk ishte shumë e lehtë. Kjo për faktin se ato nuk janë publike dhe nuk mund të gjinden në webfaqet e gjykatave të vendit, siç mund të gjenden shumë lehtë aktgjykime të shqiptuara ndaj të dënuarve madhorë. Për qasjen tek vendimet gjyqësore kemi parashtruar kërkesa formale drejtë autoriteteve kompetente të gjykatës Themelore të Tetovës, cilat u treguan kooperuese në këtë aspekt duke na ofruar një numër simbolik të këtyre shkresave, por të mjaftueshëm për të paraqitur qëllimin e kësaj pjese të punimit.

Vendimet gjyqësore janë grumbulluar nga gjykata hemelore e Tetovës (4 raste) dhe Vendimi i Gjykatës Supreme ishte i publikuar në Përmbledhjen e Vendimeve gjyqësore të kësaj gjykate për periudhën 2004-2014.

4.5 Rasti 1: Vrasje

Në vazhdim është paraqitur një rast i fëmiut të gjykuar për kryerje të veprës penale Vrasje

Pjesë nga Aktgjykim i sjellur nga Gjykata Themelore Tetovë, 2017, KM-16/17:

“(NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Gjykata Themelore e Tetovës, si gjykatë penale e shkallës së parë, në Këshill për fëmijë të përbërë nga gjykatësi për të mitur-XX si Kryetar i Këshillit dhe gjykatësit porotë AK dhe SG-si antarë të Këshillit, vendosi sipas Propozimit për shqiptim të dënimit me burgim nga Prokuroria Themelore Publike – Tetovë për veprën penale VRASJE, në bazë të nenit 123 p.1 i KPM, ku pas zhvillimit të shqyrtimit kryesor gojor dhe të mbyllur, në prezencë të prokurorit publik, përfaqësuesit ligjor të të dëmtuarve, mbrojtësit të fëmiut të akuzuar dhe fëmiut, u soll ky Aktgjykim kundër fëmiut XX , të lindur në vitin 2000, shtetas i R.M., i privuar nga liria në datë X.X. 2017 e solli këtë:

AKTGJYKIM

FËMIU I AKUZUAR XX, i lindur më X.X.1999...shqiptar, shtetas i R.M.,

SHPALLET FAJTORË:

SEPSE në datë X.X. 2017 në orën 16.00, në X, në oborr të X me paramendim e ka privuar nga jeta fëmiun X nga i njeiti fshat, në atë mënyrë që me përdorimin e armës së zjarrit – armë pistoletë, ngjyrë të zezë, marla “Paarabelum M-90,”9mm me numër serik XX, ka qëlluar nga një afërsi e afërt një plumb në shpinën e të dëmtuarit XX edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se përshkak të veprimit të tij mund të rezultojë pasojë e dëmshme, por duke u pajtuar me paraqitjen e saj, me të cilën i ka shkaktuar plagë nga arma e zjarrit nga shpina drejtë pjesës së parme të anës së majtë, i cili si rast urgjent është sjellur në Qendrën e urgjencës në Shkup dhe pas realizimit të operacionit, pas tri ditësh tek fëmiu i dëmtuar ka pasuar vdekja, me të cilin veprim e ka kryer veprën penale VRASJE sipas n. 123 p.1 i Kodit penal.

Në pajtim me n.51 të Ligjit të drejtësisë për fëmijë:

DËNOHET

Me dënim me burgim për fëmijë në kohëzgjatje prej 8-tetë vitesh.

Në dënimin e shqiptuar do të llogarritet edhe koha e kaluar në paraburgim deri në lëshimin e tij.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të buxhetit të Republikës së Maqedonisë. I dëmtuari X për kërkesën e tij juridiko-pasurore drejtohet në kontest civil. Kurse mjeti i përdorur për të kryer veprën penale (Pistoleta) I MERRET.

Arsyetim

Nga ana e PPTH- Tetovë nr.19/17 nga X.X.2017. është parashtruar Propozim për shqiptim të dënimit burgim për fëmijë ndaj fëmiut X nga X për veprën penale VRASJE sipas n.123, p.1 nga KP.

Duke vepruar sipas Propozimit, gjykata mbajti shqyrtim kryesor më datë X.X.2017, në prezencë të përfaqësuesit të Prokurorisë publike Tetovë, përfaqësuesit të të dëmtuarve, mbrojtësit të të akuzuarit dhe fëmiut.

Në shqyrtimin e mbajtur kryesor fëmiu i akuzuar vullnetarisht e pranoi fajin për veprën e kryer, i vetëdijshëm për pasojat nga pohimi i tillë, prandaj edhe gjyqi e shpalli fajtor për këtë veprë penale dhe e dënoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë vitesh...”).

Gjatë matjes së dënimit në këtë rast gjykata i kishte marrë parasysh të gjitha rrethanat sipas n. 39 të KPM-së, ku si rrethana rrënduese në pjesën e Arsyetimit kishte përcaktuar: Llojin dhe karakterin e veprës penale dhe mospajtimin me familjen e fëmiut të ndjerë, kurse si rrethana lehtësuese - gjendjen materiale të fëmiut, repektivisht situatën se i njeiti rrjedh nga një familje e varfër- fakt i cili u vërtetua me dokument të siguruar nga QPS –Tetovë, situatën se vjen nga familje me nivel të ulët socio-kulturor dhe edukativ; I njeiti është emocionalisht i papjekur dhe jostabil si dhe i papërgjegjshëm – e nxjerrur nga mendimi dhe konstatimi i ekipit profesional nga QPS Tetovë; Rrethana se në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për ta kuptuar rëndësinë e veprës si dhe zotësia për të kontrolluar veprimet e tij ka qenë e zvogluar – e nxjerrur nga ekspertimi neuropsikiatrik, si dhe pendimi i fëmiut.

Fëmiu ka qëndruar në paraburgim dy muaj pas momentit kritik, që len të nënkuptohet fakti se shkak i përcaktimit të paraburgimit në këtë rast mund të ketë qenë pikërisht gjendja jostabile e fëmiut apo ekzistimi i ndonjë kushti tjetër të përcaktuar ligjor (sipas LPP të R.Maqedonisë).

Në këtë rast konsideroj se duke pasur parasyshë rrethanat e natyrës subjektive që lidhen me gjendjen emocionale të kryesit, kohëzgjatja e përcaktuar e dënimit me burg nga ana e gjykatës - deri në 8 vite është e përshtatshme për rastin në fjalë. Kjo sepse kryesi në fjalë sipas gjendjes emocionale të tij të përshkruar nga eksperti përkatës, ka pasur nevojë për një tretman penitenciar më të gjatë me qëllim të (ri)edukimit të tij, e mesiguri edhe gjykata e ka konsideruar këtë fakt në momentin e matjes së dënimit, krahas shkallës së rrezikshmërisë së veprës penale të kryer.

4.6 Rasti 2: Vjedhje e rëndë

Në vazhdim është paraqitur një rast i fëmiut të gjykuar për kryerje të veprës penale Vjedhje e rëndë.

Pjesë nga Aktvendimi i sjellur nga Gjykata Themelore Tetovë, 2017, KM-28/17:

“(Gjykata Themelore e Tetovës, si gjykatë penale e shkallës së parë, në Këshill për të mitur të përbërë nga gjykatësi për të mitur dhe gjykatësit porotë, duke vendosur sipas Propozimit për shqiptim të masës edukuese nga Prokuroria Themelore Publike – Tetovë ndaj fëmijëve X dhe Y për veprën penale VJEDHJE E RËNDË , në bazë të nenit 236 p.5 në lidhje me p.1, al.1, në lidhje me n. 22 të KPM, ku pas zhvillimit të shqyrtimit kryesor gojor dhe të mbyllur, në prezencë të prokurorit publik, mbrojtësve të fëmijëve, e në mungesë të fëmijëve dhe Përfaqësuesit të QPS- Tetovë, me datë X.X.2017, e solli këtë:

AKTVENDIM

NDAJ FËMIUT:

1. X, i lindur më X.X.1999...shqiptar, shtetas i R.M.,
2. Y, i lindur më X.X.2000...shqiptar, shtetas i R.M.,

Në pajtim me n.37 dhe 41 të Ligjit të drejtësisë për fëmijë ju shqiptohet masa edukuese:

1. MBIKQYRJE E SHTUAR NGA ANA E PRINDËRVE

Masa edukuese do të zgjasë së paku 1-një, e më së shumti 3-tri vite, për të cilën gjykata do të vendos në mënyrë plotësuese.

Prindërit detyrohen ti menjanojnë ndikimet e dëmshme ndaj fëmijëve.

Shpenzimet e procedurës për të dy fëmijët bien në ngarkesë të buxhetit të R.M.

I dëmtuari X për kërkesën e tij juridiko-pasurore drejtohet në kontest civil.

Arsyetim

....Pas njoftimit të të pranishmive për ecurinë e procedurës përgaditore dhe pas shqyrtimit të provave të propozuara gjyqi vërtetoi se fëmijët me të vërtetë gjatë natës mes XX/X.X /**2014**, në f.X, nga marketi XX në pronësi të X, si bashkëkryerës, me thyerje, kanë marrë sende të huaja të luajtshme me vlerë të vogël, me qëllim të përvetësimit të tyre të paligjshëm, në mënyrë me çka me mjet të fortë – pllakë begatoni e kanë thyer qelqin e shitores nga dera e hyrjes, janë futur brenda dhe nga sirtari kanë marrë dy kartona “Malboro, të bardhë”, dy kartona “Malboro” të kuq, një kuti “Malboro” të kuq me të bardhë, dy kuti “West” ngjyrë hiri dhe një kuti “West” të kuq, me vlerë të pavërtetuar në veçanti, kurse në vlerë totale nga 9000 denarë , ku pastaj janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Fëmijët pavarësisht nga njëri tjetri e pohojnë këtë gjendje faktike. Vërtetojnë se me të vërtetë në kohën kritike kanë hyrë brenda në marketin “X” nga dera e hyrjes së marketit dhe se nga brenda kanë marrë më shumë pako të cigareve të ndryshme e pastaj e kanë lëshuar vendin.

I dëmtuari dëshmitar X vërtetoi pohimet e dhëna të fëmijëve...

Në këtë situatë faktike të vërtetuar gjyqi u përcaktua që fëmijëve të u’a shqiptojë masën edukuese Mbikqyrje e shtuar nga ana e prindërve si proporcionale me peshën e veprës penale të kryer dhe adekuate për moshën dhe përgjegjësinë e tyre, në të cilën shpie rrethana se ata rrjedhin nga familje me nivel të mesëm socio-kulturor dhe edukues, se vepra e kryer është e karakterit të rastësishëm, se kanë kushte të mira për zhvillim si dhe se premtojnë se kesi apo gabim i ngjashëm në të ardhme nuk do të i’u ndodhë – rrethana të cilat dalin nga mendimi dhe konstatimi i ekipit profesional të QPS Tetovë...”).

Nga ky rast mund të vërtetojmë një fakt që paraqet një veçori të përbashkët apo të shpeshtë të delikuencës së fëmijëve – kryerja në bashkëpunim e veprës penale nga fëmijët. Pra, për dallim nga kryesit madhorë, fëmijët më së shpeshti gjatë kryerjes së veprës penale operojnë në bashkëpunim e më rrallë vetë. Kjo ndodh, deri sa ata të fitojnë vetëbesimin në vetvete për të operuar vetë.

Siç shihet në këtë rast, gjykata ka shqiptuar një masë edukuese e cila shpesh shqiptohet ndaj kryesve fëmijë në vendin tonë (bazuar në të dhënat zyrtare të Entit Statistikor) – Mbikqyrje e përforcuar nga ana e prindërve.

4.7 Rasti 3: Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prokusorëve

Në vazhdim është paraqitur një rast i fëmiut të gjykuar për kryerje të veprës penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prokusorëve.

Pjesë nga Aktvendim i sjellur nga Gjykata Themelore Tetovë, 2017, KM-29/17:

“(Gjykata Themelore e Tetovës, si gjykatë penale e shkallës së parë, në Këshill për të mitur të përbërë nga gjykatësi për të mitur dhe dy gjykatësit porotë, duke vendosur sipas Propozimit për shqiptim të masës edukuese nga Prokuroria Themelore Publike – Tetovë ndaj fëmiut X për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prokusorëve, në bazë të nenit 216 p.2 në lidhje me p.1 të Kodit penal, ku pas zhvillimit të shqyrtimit kryesor gojor dhe të mbyllur, në prezencë të Prokurorit publik, mbrojtësit të fëmijut, e në mungesë të fëmiut dhe përfaqësuesit të QPS- Tetovë, me datë X.X.2017, e solli këtë:

AKTVENDIM

NDAJ FËMIUT:

1. X, i lindur më X.X.2000...shqiptar, shtetas i R.M. në pajtim me n.37 dhe 43 të Ligjit për drejtësinë për fëmijë i shqiptohet masa edukuese:

MBIKQYRJE E PËRFORCUAR NGA ANA E QENDRËS

Masa edukuese do të zgjasë më së paku 1-një vit e më së shumti 3-tri vite, për të cilën gjyqi do të vendosë në mënyrë plotësuese.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të buxhetit të R.M.-së.

A r s y e t i m

...Pas njoftimit të të pranishmëve për vijimin e procedurës përgaditore dhe pas shqyrtimit të provave të propozuara, gjyqi vërtetoi se fëmiu me tëvërtetë më X.X.2017, rreth orës 22.30 në X sheshin e qytetit në mënyrë të paautorizuar për shitje ka mbajtur një sasi të vogël të drogës narkotike marihuanë me masë neto 2,55 gramë në mënyrë që është hasur nga ana e punonjësve policorë të MPB Tetovë se si personit X duke i shitur një qese të paketuar me drogën narkotike marihuanë me masë neto 0,92 gramë, kurse me vete ka mbajtur edhe dy paketime me nga 0,79 gramë dhe 0,84 gramë ose gjithsej 1,63 gramë të cilat me vërtetim i janë marrur.

Fëmiu e pohoi këtë gjendje faktike, pranon se në kohën dhe vendin kritik me të vërtetë ka qenë i ndalur nga punonjësit policor me paketimet e marihuanës nga të cilat njërin i'a ka dhënë X dhe se marihuana e gjetur menjëherë i është marrë me vërtetim.

Dëshmitari X në mënyrë shumë identike u deklarua në lidhje me faktet e përmendura nga ana e fëmiut. Në dëshminë e tij të dhënë më X.X.2017, me siguri e potencon se personalisht e ka njohur X dhe se nga ai afër sheshit të qytetit X ka blerë paketim marihuanë për 200 den....”).

Pas vërtetimit të gjendjes faktike të shprehur më lartë në Arsyetimin e vendimit, gjykata është përcaktuar që fëmiut të i'a shqiptojë masën edukuese Mbikqyrje e shtuar nga ana e Qendrës. Kjo masë konsideroj se është proporcionale me peshën e veprës penale të kryer dhe e përshtatshme me moshën e tij, në të cilën drejton rrethana se bëhet fjalë për fëmijë të lënë pas dore, i cili rrjedh nga familje me nivel të ulët socio-kulturor, emocionalisht është i papjekur dhe jostabil, jo vetë kritik dhe i papërgjegjshëm, vështirë socializohet – rrethana të cilat dalin nga konstatimi dhe mendimi i ekipit profesional të QPS – Tetovë.

4.8 Rasti 4: Vrasje

Në vazhdim është paraqitur një rast i fëmiut të gjykuar për kryerje të veprës penale Vrasje.

Pjesë nga Vendimi në Seancë të Përgjithshme - Zbatim i gabuar i Kodit penal, i sjellur nga Gjykata Supreme e R.M.-së më 9/2008:

“(“ NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË”

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, në Seancë të përgjithshme nën kryesi të kryetarit të Gjykatës Supreme të R.M. me procesmbajtës – Sekretari gjeneral i gjykatës, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë III. KO3.nr. 3/2008 nga 19.03.2008, kundër Aktgjykimit të Këshillit për vendosje sipas kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Supreme të R.M. K.nr.211/07 nga 10.10.2007, të mbajtur më 24.06.2008, në prani të Prokurorit të përgjithshëm nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, K.n. në pajtim me n.35, p.1, al.6 të Ligjit mbi gjykatat dhe n.22, p.8 dhe n.308 të Ligjit të procedurës penale, solli:

AKTGJYKIM

Kërkesa e Prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë për mbrojtje të ligjshmërisë III. nr.3/2008 nga 10.03.2008, PRANOHET.

Aktgjykimi i Këshillit për vendosje sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë nr.211/07 nga 18.10.2007, NDRYSHOHET DHE VENDOSËT: Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të

aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Themelore në K. KM.nr.7/06 nga 16.03.2007 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në S. KKM. nr.7/07 nga 21.05.2007, parashtruar nga mbrojtësi i të dënuarit, të miturit të vjetër B.S. nga K. V.T. mbrojtës nga B. Dhe J.T. , mbrojtësi nga S., REFUZOHET SI E PA BAZË.

Arsyetim

Gjykata Themelore në K. me Aktgjykim nr. 7/06 –I nga 16.03.2007, të akuzuarin, të miturin e vjetër V.S. nga K. E shpalli fajtor për veprën penale “Vrasje” sipas nenit 123, p.1 të KPM dhe e dënoi me burgim për të mitur në kohëzgjatje prej 8-tetë vjet dhe 6-gjashtë muaj, me të cilin i kishte llogarritur edhe kohën e kaluar në paraburgim, të llogarritur nga 06.09.2006. Ndaj të akuzuarit ishte shqiptuar edhe masa e sigurisë – marrja e sendeve, nga i cili ishin marrë: Pistoleta gjysmëautomatike e tipit “Numerator çek” model 50, kalibër 7,65 me numër fabrike C15082, me një kornizë me 45 plumba.

I akuzuari ishte obliguar të paguajë 4.000,00 denarë në emër të shpenzimeve gjyqësore paushale dhe ti kompenzojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 29.900,00 denarë, tërë në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. I dëmtuari T.S. për kërkesën e parashtruar pasurore-juridike është drejtuar në kontest të rregullt civil.

Gjykata e Apelit në S. me Aktgjykim nr.7/2007 nga 21.05.2007, ankesën e të akuzuarit, të miturit të vjetër V.S. të parashtruar përmes mbrojtësve V.T., B i J.T., pjesërisht e ka pranuar, aktgjykimin e Gjykatës Themelore nr.7/2006-I nga 16.03.2007, e ka ndryshuar vetëm në pjesën që i referohet vendimit për sanksionin penal, kështu që i akuzuari, i mituri i vjetër V.S., për veprën penale “Vrasje”, sipas n.123, p.1 nga KPM, përshkruar në aktgjykimin e ankimuar, për të cilën është shpallur fajtor, e është dënuar me dënim burgim për të mitur në kohëzgjatje prej 5-pesë vitesh, në të cilën i’a ka llogarritur edhe kohën e kaluar në paraburgim, nga X.YY.2006 deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Në pjesën tjetër Aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Duke vendosur në bazë të Kërkesës për Rishikim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm, të parashtruar nga mbrojtësit e të dënuarit, të miturit të vjetër V.S. nga K., mbrojtësi V.T. dhe J.T, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë – Këshilli për vepra penale, me aktgjykimin e goditur nr. 211.2007 nga X.YY.2007, ka ardhur në qëndrimin se në rastin konkret nuk janë plotësuar elementet ligjore të veprës penale Vrasje nga n.123, p.1 i Kodit penal.

Sipas mendimit të Këshillit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë në veprimin e të dënuarit, të miturit të vjetër V.S. janë të përmledhura elementet e veprës penale “Vrasje nga pakujdesia” sipas nenit 126 të KPM, sepse nuk ka qenë e dëshmuar se i dënuari ka vepruar sipas një vendimi të marrë paraprakisht për të shkreptur me pistoletën, sipas të cilës aktgjykimin e plotëfuqishëm e ka ndryshuar, për zbatim të drejtë të Kodit penal, kështu që veprimet e të miturit të vjetër V.S. të përshkruara në aktgjykimin e plotëfuqishëm, i ka kualifikuar në veprën penale “ Vrasje nga pakujdesia” sipas nenit 126 nga KPM. Në pjesën tjetër aktgjykimet e goditura i ka vërtetuar.

Kundër vendimit të Këshillit të Gjykatës Supreme të R.M. , Prokurori Publik i R.M., ngriti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë III.KO3.nr.3/08 nga 19.03.2008, për lëndime thelbësore të dispozitave të procedurës penale sipas n.355, p.2, al.11 në lidhje me n.355, p.2 në lidhje me n.415,408,p.1 dhe n.409 nga Ligji i procedurës penale dhe për shkak të lëndimit të Kodit penal nga n.356, al.5 nga Ligji i procedurës penale.

Prokurori Publik i R.M. theksoi se Këshilli i Gjykatës Supreme të R.M. në këndvështrim të veprës penale që ka qenë objekt i akuzës ka zbatuar Ligj i cili nuk ka mundur të zbatohet.

Këshilli i Gjykatës Supreme të R.M. atë e ka bërë në mënyrë duke mos e pranuar kualifikimin ligjor të veprës penale, objekt i aktgjyqimit të plotëfuqishëm të goditur, “Vrasje” sipas n.123, p.1 nga KPM por ka pranuar se është kryer vepra penale Vrasje nga pakujdesia sipas n.126 nga KPM.

Në Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë vërtetohet se Këshilli i Gjykatës Supreme të R.M. nuk ka mundur veprimet e përshkruara në Aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Themelore t’i vendosë nën nocionin *Pakujdesi*. Përshkrim i tillë i elementeve të rëndësishme të veprës penale nga neni 126 i KP, në rastin konkret nuk ekzistojnë dhe prova të tilla gjatë procedurës së shkallës së parë dhe të dytë nuk janë shqyrtuar, e as një gjë e tillë nuk ka ndodhur para Këshillit të Gjykatës Supreme të R.M.-së. Nga kjo, me aktgjykimin e goditur në të kundërtën e elementeve të veprës penale e cila ka qenë objekt i akuzës është zbatuar Ligj i cili nuk mund të zbatohet dhe në atë mënyrë aktgjykimi i sulmuar është i pakuptimtë, ndërsa faktet vendimtare në vendim janë nën dyshim dhe janë të kundërta me dispozitat e Ligjit të procedurës penale sepse Gjykata e ndryshon gjendjen faktike të vërtetuar me aktgjykim të shkallës së parë dhe të dytë...

...Seanca e përgjithshme konstatoi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar...

...Nga përmbajtja e aktgjyqimeve të gjykatave më të ulta del se ata kanë pranuar ekzistimin e veprës penale “Vrasje” nga neni 123, p.1 nga KP, të cilën i mituri i vjetër V.S. e ka kryer në mënyrë që me X.YY.2006 rreth orës 12,00 në K.në shtëpinë e tij me të shtënë nga pistoletë e ka privuar nga jeta të dëmtuarën e mitur M.T. nga K., edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se si pasojë e atyre veprimeve mund të pësojë pasojë e dëmshme, por është pajtuar me ndodhjen e saj, në mënyrë që pasi të dy paraprakisht janë marrë vesh se pas mbarimit të orëve mësimore të ndryshimit të parë të shkonin tek shtëpia e tij dhe pasi nga dollapi në dhomën e fjetjes ka nxjerrur pistoletën gjysmëautomatike të tipit “Numrator çek”, model 50 kalibri 7,65 me numër fabrike C 15082, pronë e babait të tij, pasi që paraprakisht ka kontrolluar a përban brenda municion dhe e ka pregaditur, ka shkrepur një plumb në gjysmën e majtë të ballit të saj, nga çka proektili metalik ka hyrë në pjesën e parme të kokës, ka çarrë lëkurën dhe kockën e ballit dhe ka dalë në pjesën e pasme të kokës së epërme së djathtë, prej nga ka ardhur deri në tronditje të indit të trurit, ku si pasojë ka ndodhur vdekja tek e mitura M.T...”

Në rastin penalo-juridik konkret, sipas gjetjeve të Seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të R.M. me siguri mund të vërtetohet se i dënuari është pajtuar me ndodhjen e pasojës së dëmshme. Kështi që, faktet të cilat janë të pakontestueshme në tërë pjesën rreth veprimeve të tij, posaçërisht shpejtësia dhe aftësia për ta vendosur në gjendje të përdorimit pistoletën, shpiejnë në përfundimin se i dënuari në asnjë moment nuk ka mundur të presë se nga veprimi i armës që e ka përdorur nuk do të ndodhë pasoja e dëmshme, ose se do ta largonte nëse e njehta do të ndodhte. Nëse merret parasysh edhe rrethana konkrete se pasoja ka ndodhur- vdekja e të dëmtuarës, ekziston vetëm një përfundim i mundshëm, e kjo që i

dënuari ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit të tij mund të ndodhte pasoja e dëmshme, por është pajtuar me ndodhjen e saj. Përshkak të gjithë asaj që është përmendur më lartë, Gjykata Supreme e R.M.-së në Seancën e përgjithshme, kërkesën për mbrotje të ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori publik i R.M. III KO#.nr.3/2008 nga X.YY.2008 kundër Aktgjykimit të Këshillit për vendosje sipas Kërkesës për Rishikim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm në sektorin e veprave penale në Gjykatën Supreme të R.M. nr. 211/07 nga XX.Y.2007, e pranoi dhe aktgjykimin e goditur e ndryshoi në mënyrë që Kërkesën për rishikim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm të parashtuar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në K. Nr.06-I nga 16.03.2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Sh. Nr.7/2007 nga 21.05.2007, e refuzoi si të pabazuar.¹¹¹

Qëllimi i paraqitjes së vendimeve gjyqësore në këtë kapitull, duke përkrahur Dispozitivin e tyre, si dhe pjesë të caktuara të Arsytimit të tyre ishte pasqyrimi i rasteve të caktuara penale me të cilët fëmijët e gjykuar janë shpallur fajtorë për kryerje të veprave penale. Nga këto raste, mund të nxjerrim në pah disa elementeve të rëndësishme si:

- **Lloji i veprave penale** të cilat i kanë kryer fëmijët – Janë përzgjedhur raste të veprave të ndryshme penale, si: **Vrasje** (rasti 1 dhe 4); **Vjedhje e rëndë** (rasti 2); **Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prokusorëve** (rasti 3); Nga këto raste mund të përfundojmë se fëmijët paraqiten si kryes të veprave të ndryshme penale, sikurse edhe kryesit madhorë, dhe
- **Lloji i sanksionit penal** që gjykatat u'a kanë shqiptuar fëmijëve të gjykuar për veprën penale përkatëse – janë përzgjedhur vendime me të cilat gjykatat kishin shqiptuar lloje të ndryshme të sanksioneve penale, disa lloje të masave edukuese, por nuk mungojnë edhe raste ku gjykatat kanë shqiptuar dënimin me burgim për fëmijë.

¹¹¹ ЗБИРКА на судски одлуки 2004-2014, (11), 2015, f. 10-16

4.9 Rasti 5 : Grabitje

Kërkesë

Për fillimin e procedurës përgaditore

Ndaj të miturit:

R.Z. nga prindi E.Z. dhe M.Z. i lindur më 24.04.2000 në Tetovë, ku dhe banon në rrugën X me numër XX, me numër amë XX, Shqipëtar, nënshtetas i R.M. ndaj të cilit janë ngritur (inicuar) me shumë akt padi për kryerje të veprës penal.

Për të cilin dyshohet se:

Më datë 02.11.2017, rreth orës 23:00 në Tetovë, me kërcënim se do sulomjë duke rezikuar jetën dhe trupin e të dëmtuarit X. Nga Tetova, duke përdorur armë të ftohtë- thikë, ka rrëmbyer mjete të lëvizshme të huaja në kundërshtim të ligjit, dhe në këtë mënyrë është futur i maskuar në bastoren sportive X me lokacion X në Tetovë, duke e kërcënuar me thikë të dëmtuarin dhe të punësuarin X nga Tetova, i cili në atë moment ka qenë duke e pastruar lokalit, duke i u drejtuar me fjalët: “ Mos lëviz, mos u kthe” duke u drejtuar drejt tavolinës prej së cilës ka marrë mjete me vlerë prej 20000 denarë, dhe më pas është arratisur.

Me të cilën vepër i mituri ka kryer veprën penale të GRABITJES të nenit 237. F.4 në lidhje me F.1 nga Kodi Penal.

Baza e dyshimit se i mituri ka kryer veprat penale, del nga akt padia e sektorit të punëve të brendëshme K.U.nr.757 nga data 20.11.2017.

Gjatë rjedhës së procedurës përgaditore, do të ndërmeren veprat në vazhdim:

1. Do të ndëgjohet i mituri i dyshuar në prezencë të përfaqësuesit ligjorë, në të gjitha rethanat në lidhje me lëndën penale të ngjarjes, dhe të shqyrtohet mbrojtja e të njëjtit.

2. Në pozitë e dëshmitarit dhe të dëmtuarit do të ndëgjohej S.N. në lidhje me atë se çka ka parë , ndëgjuar dhe din reth ngjarjes përkatëse. Ndërsa në rast se i mituari nuk e pranon padinë penale, dëshmitari në prezencë të prokurorit publik do të kryej kallëzim penal në hapsirat e Sektorit të punëve të brendëshme Tetovë.
3. Nëpërmjet J.U Qendrës komunale për punë sociale në Tetovë do të sigurohet dokument zyrtar-mendim në lidhje me të miturin R.Z.
4. Nga shërbimi amë për udhëheqje të librave amë, do të sigurohet çertifikatë e lindjes nga MKR për të miturin R.Z.

Gjykatësi për të mitur në gjyqin themelor të Tetovës J.V, duke ndërmarë veprim sipas propozimit për caktimin e masës së sigurisë-paraburgim të Prokurorisë publike Tetovë VII kod.nr.53/17 dhe 54/17 me datë 20.11.2017, kundrejtë të miturit R.Z nga Tetova, përshkak të dyshimit bazë se ka kryer veprën penale GRABITJE të nenit 237 fq.4 n.m. fq.1 të K.P. dhe VJEDHJE SË RËNDË të nenit 236 fq.1 n.m. fq1. dhe n.m n.22 të K.P.3 me date 20.11.2017 ka marrë këtë vendim:

VENDIMI

Ndaj të miturit:

R.Z. nga prindët E.Z. dhe M.Z. i lindur më 20.04.2000 në Tetovë ku dhe banon, në rrugën X me nr amë X, nacionaliteti X, nënshtetas i RMV.

Caktohet paraburgim me afat kohorë 30 ditor- në pajtim me ligjin 165.fq.1.t.1.2 dhe 3 nga ZKP, për veprat penale GRABITJE të nenit 237 fq.4 n.m. fq.1 të K.P. dhe VJEDHJE SË RËNDË të nenit 236 fq.1 n.m. fq1. dhe n.m n.22 të K.P.3 me date 20.11.2017.

Paraburgimi do të vlejë prej më 20.11.2017, ora 15:00.

Masa e caktuar e paraburgimit do të kryhet në KPU Burgu i Shkupit- Shutka.

Aktgjykimi

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË!

GJYKATA THEMELORE TETOVË, si gjyqi penal i shkallës së parë, në këshillin për të mitur i përbërë nga gjykatësi për fëmijë J.V. i- si kryetar i këshillit dhe i gjykatësve- përkatës Xh. A. dhe D. J. - si pjesëtar të këshillit, me evidentues B. A. duke marrë vendim sipas propozimit të burgut për fëmijë OJO- Tetovë kodi nr. 54/17 me 20.11.2017, ndaj R.Z. nga Tetova për vepra penale grabitje sipas nenit 237 fq. 4 n.m. fq. 1 prej K3 dhe vjedhje me dhunë sipas nenit 236 fq. 1 n.m. nenin 22 nga K3, pas mbajtjes së fjalimit gojor, jopublik dhe kryesor në prezencë të prokurorit publik D.D mbrojtësi i të miturit avokat M.R më datë 25.12.2017, solli këtë aktvendimë:

I pandehuri

R.Z. me prind E.Z dhe M.Z i lindur më 20.04.2000 në Tetovë, ku edhe jeton në rrugën “Goce Delcev” nr. 11, shqiptar, shtetas I RM, nr. amë-470018, i privuar nga liria më datë 20.11.2017 ora 15.00.

Ai është fajtor pasi që

1. Më datë 02.11.2017 rreth orës 23.00 në Tetovë, me kërcënim se drejtpërdrejtë do të sulmonte mbi trupin e të dëmtuarit S.N nga Tetova, me anë të një arme të rrezikshme- thikë, i maskuar hyri në bastoren “Mocart” me lokacion në rrugën “T.Xh. Merxhan” nr. 53 në Tetovë duke e kërcënuar me thikë të lënduarin dhe I punësuar S.N nga Tetova I cili në atë moment ka qenë duke e pastruar lokalin, kur djali I ishte drejtuar me fjalët “Mos lëviz, mos u kthe” dhe direct kishte marrë drejtimin për tek tavolina ku kishte marr mjete financiare rreth 20.000 denarë dhe më pas ishte larguar nga vendi I ngjarjes.

-Me këtë vepër ai e kreu aktin penal grabitje sipas nenit 237 fq. 4 n.m. fq. 1 nga K3.

2. Me datë 16.11.2017, rreth orës 21.00 në Tetovë, si bashkëpuntorë me A.A kanë tentuar me anë të vjedhjes që ti përvetësojnë në atë mënyrë që paraprakisht kishin rënë dakord të shkojnë në bastoren “Mart- Bet” përderisa I rrituri A.A mbajti rroje, I mituri R.Z u fut në objektin ku gjendej e punësuar- pastruese S.K e cila e pastronte lokalin, shkoi në drejtim të arkës e cila ishte e mbyllur e hapi dhe nga ajo mori një shumë parash prej 8750,00 denarë, e më pas bashkë

me A.A shkuan në drejtim të kompleksit Lovec dhe rr. Ilindenit, morën taksi për në Uo “Kiril dhe Metodij”, blejtën birra dhe me taksi tjetër janë drejtuar për tek parku i gruas duke i ndarë paratë.

- Me këtë vepër e kreu aktin penal vjedhje me dhunë sipas nenit 236 fq. 1 n.m. nenin 22 nga K3. Në përputhje me nenin 51 dhe 58 nga ligji për të drejtat për fëmijë gjykohet :

- me dënim burg për fëmijë me kohëzgjatje prej 2 vite.

Në dënimin e cekur do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga 20.11.2017 deri në lëshimin e tij.

Shpenzimet e procedurës bëhen nga buxheti i RM.

Të dëmtuarit S.N nga Tetova dhe I.J nga Tetova për dëmshpërblimet e tyre i drejtohen gjyqit.

Arsyetim

Nga ana e OJO- Tetovë kod. Nr. 54/17 prej 20.11.2017, është sjellë vendim për burgim për fëmijë ndaj të miturit R.Z nga Tetova për veprat penale grabitje sipas nenit 237 fq. 4 n.m. fq. 1 nga K3 dhe vjedhje me dhunë nenit 236 fq. 1 n.m. nenin 22 nga K3.

Sipas propozimit, gjykata mbajti fjalimit gojor, jopublik dhe kryesor në prezencë të prokurorit publik D.D mbrojtësi i të miturit avokat M.R.

Në fjalimin e mbajtur i pandehuri vullnetarisht e pranoi fajin për veprat e kryer, i vetedijshe për pasojat, për atë edhe gjykata e shpalli fajtor për këta vepra penale dhe e dënoi me 2 vjet burg. Në kohëzgjatjen e dënimit gjykata i mori parasysh gjithë rrethanat të parapara me nenin 39 të kodit K3, karakterin e veprave penale, dëmin e shkaktuar, rrethanat që nuk janë tërhequr dëmete pasuara si dhe rrethanat që i mituri ka kryer edhe vepra të tjera penale dhe që kundër tij zhvillohen edhe masa të tjera për veprimtaritë e kryera penale, ndërsa si masë lehtësuese është pranimi i veprimtarisë që ka bërë, pendimi i dëshmuar si dhe gjendja materiale e të miturit gjegjësisht rrethanat që ai rrjedh nga një familje me nivel të ulët social kulturor, mendim ky që vjen nga CSR- Tetovë. Harxhimet e gjykimit i takojnë buxhetit të RM.

Aktvendim i gjyqit themelor Tetovë.

Përfundime

Tendencat bashkëkohore të veprimit me fëmijë përcillen nga dispozitat të cilat dalin nga dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare për drejtësinë për fëmijë, siç janë Konventa Evropjane për të drejtat e fëmijës, dokemnte të OKB-së si dhe rekomandime të KE-së. Si rezultat i tendencës së këtyre instrumentave ndërkombëtare edhe ligjislacioni pozitiv i vendit tonë i cili rregullon procedurën penale ndaj fëmijëve dhe drejtësinë ndaj fëmijëve në përgjithësi paraqet një sistem të përbërë nga dy komponenta: Drejtësi për fëmijët dhe mirëqënie të fëmijëve.

Procedura penale ndaj fëmijëve karakterizohet me specifikat e veta të cilat e bëjnë atë të dallohet nga procedura penale e cila zhvillohet ndaj të pandehurve të moshës madhore. Ligji mbi drejtësinë për fëmijë e rregullon zhvillimin e procedurës gjyqësore ndaj fëmijëve të dyshuar për kryerje të veprave penale dhe nga ajo që u trajtua në këtë punim shihen qartë specifikat që i përmbanë kjo procedurë. Dallimet vërehen në shumë pika, por si më të rëndësishme mund të veçohen: Kërkesa e profesionalizimit të subjekteve proceduralë që i trajtojnë fëmijët në të gjitha stadet e procedurës penale, meçrast kërkohet që punonjësit policorë, avokatët, gjykatësit të ndjekon brenda vitit së paku për 5 ditë trajnime nga sfera e drejtësisë për fëmijë dhe të drejtave të fëmijëve-në vend ose jashtë vendit.; Poashtu prezenca e domosdoshme e përfaqësuesit nga Qendra për punë sociale në ç'do fazë të procedurës penale ndaj fëmiur; Mbrojtja e domosdoshme; Pjesëmarrja e prindit/kujdesitarit të fëmiut; Dhënia përparësi masave edukuese dhe masave të ndihmës dhe mbrojtjes, dhe zbatimi i parimit sipas të cilit privimi nga liria i fëmiut të jetë mjet i fundit; Mbrojtja e interesit të fëmiut, parimi i oportunitetit etj.

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në kapitullin e fundit të punimit, të marra nga publikimi i fundit i Entit shtetëror statistikor për periudhën kohore 2012-2017 shihet dukshëm zvogëlimi i

numrit të fëmijëve të cilët janë paraqitur si kryerës të veprimeve të ciat me ligj parashihen si vepra penale.

Poashtu ekziston tendenca e rrënies së numrit të fëmijëve të akuzuar nga viti në vit, edhe pse jo me një diferencë shumë të theksuar, por që paraqet një tregues pozitiv për dinamikën e fenomenit të kriminalitetit të fëmijëve në vendin tonë.

Nga të dhënat për numrin e fëmijëve të gjykuar për vitit 2012-2017 vërehet se numri i fëmijëve të gjykuar nga viti në vit shkon në rrënie. Poashtu numri i fëmijëve të paraqitur dhe të atyre të akuzuar në raport me numrin e fëmijëve të gjykuar, është shumë më i vogël në krahasim me dy të parët.

Mund të arrijmë në përfundim se kriminaliteti i fëmijëve në vendin tonë shkon në tendencë të rrënies viteve të fundit dhe se politika preventive ka treguar rezultate pozitive në drejtim të luftimit të këtij fenomeni.

Bibliografia

4.5. LIBRA DHE PUNIME SHKENCORE

- Buzharovska,G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015
- Arifi, B. (2017). THE CHILD CRIME PHENOMENON IN REPUBLIC OF MACEDONIA: 2006-2015. ANNUAL of ISPJR , XLI (I), 103-104.
- Kambovski, V. (2007). E DREJTA PENALE Pjesa e përgjithshme. Shkup: Furkan ISM.
- Kambovski, V., Maloletnicka pravda, Shkup, 2008
- Кнежевиќ, С. (2010). Малолетничко кривично право- материално, процесно и извршно, Проект: Право на пристап правосуду, Ниш.
- „Сторители на кривични дела во 2017„,("Perpetrators od criminal offences in 2017"), Статистички преглед: Население и социални статистики, Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, 2.4.18.07 (898), Shkup, Qershor, 2018.
- Latifi, V., Elezi, I., Hysi ,V. "POLITIKA E LUFTIMIT TË KRIMINALITETIT", Prishtinë, 2012
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ("Rregullat e Pekinit" -1985), United Nation Standard Minimum Rules for the juvenile justice (The Beging Rules)
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve që u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990); United Nation Rules for the Protection of Juveniles Deprived of their Liberty (Havana Rules)
- Sahiti E., Zejneli I. (2017). E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë. Tetovë.
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Rijadit); Titulli original: UN Guidelines for the Prevention of Juvenile Delinquency (Riyadh Guidelines)

- Zejneli, I. (2008). Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë. Tetovë.
- Zejneli, I. (2018). Delikuenca e të miturve. Tetovë/ Prishtinë.

4.6. KONVENTA, KUSHTETUTA, KODE, LIGJE

- Konventa e OKB për të drejtat e fëmijës 1989 (Convention on the Rights of the Child- (CRC))
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 52 nga 22.11.1992 me Amandamentet plotësuese I-XXXII. Shkup.
- Kodi penal i Republikës së Maqedonisë. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr: 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014.
- Ligji penal i Republikës Socialiste të Federatës Jugosllave. "Gazeta Zyrtare e F.D." nr. 44/76, 34/84, 74/84, 57/89, 3/90,38/90, dhe "G.Z. e R.M." nr. 25/92, 32/93.
- Ligji penal i Republikës Socialiste të Maqedonisë. " Gazeta Zyrtare e R.S.M.", nr. 25/77, 23/84, 50/87, 36/89,7/90, 23/91, 24/92, 49/93.
- Ligji për drejtësinë e të miturve i Republikës së Maqedonisë. (2007). ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2007, 103/2008, 161/2008 dhe 145/10).
- Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013.
- Ligji mbi Policinë i Republikës së Maqedonisë (Tekst i Spastruar). (Mars, 2015). ("Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 114/04, 6/09, 145/12, 41/14, 33/15, 148/08).

- Ligji mbi gjykatat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 58/2016, 62/2006, 35/2008 dhe 150/2010);
- Ligji për Prokurorinë Publike, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 80/92, 19/93, 9/94, 9/96, 150/2007)
- Ligji mbi avokaturën...
- Ligji I punëve të brendshme...
- Ligji për mbrojtje të fëmijëve...
- Ligji për mbrojtje të dëshmitarëve...
- LPP

4.7. VENDIME GJYQËSORE

- Gjykata Themelore Tetovë. (201). KM- / . Tetovë.
- Gjykata Themelore Tetovë. (201). KM- / . Tetovë.
- Gjykata Themelore Tetovë. (201). KM- / . Tetovë.

4.8. PUBLIKIME NË SAJTE

- <http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=43>
- <http://www.slvesnik.com.mk/content/Ustav%20na%20RM%20-%20makedonski%20-%20FINALEN%202011.pdf>
- <https://www.unicef.org>.